

**BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT**
Raporti i revizorit të pavarur dhe
Raportet financiare të përgatitura në pajtim me
Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për vitin
që mbaron më 31 dhjetor 2022

Përmbajtja

	Faqja
Raporti i revizorit të pavarur	1 – 2
Raporti i të ardhurave	4
Raporti i të ardhurave gjithëpërfshirëse	4
Raporti i gjendjes financiare	5 – 6
Raporti për ndryshimet në kapital	7
Raporti i flukseve të parasë	8
Shënime në raportet financiare	9 – 85

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën 2022/2021

Anita Angellovska-Bezhoska, guvernatore
Fadil Bajrami, viceguvernator
Emilija Nacevska, viceguvernator
Ana Mitreska, viceguvernatore
Sinisha Naumoski, anëtar joekzekutiv
Gadaf Rexhepi, anëtar joekzekutiv
Borçe Trenovski, anëtar joekzekutiv (nga 1 qershor 2021)
Nikolla Popovski, anëtar joekzekutiv (nga 1 qershor 2021)
Marjan Petreski, anëtar joekzekutiv (nga 1 qershor 2021)

Selia

bul. "Kuzman Josifovski-Pitu", numër 1
1000, Shkup

Raporti financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë MKD, përderisa nuk është përcaktuar ndryshe)***RAPORTI I TË ARDHURAVE**

	Shënim	2022	2021
Të ardhurat nga interesit		497.572	97.272
Shpenzimet e interesit		(538.498)	(200.507)
Efektet e interesit negativ		19.071	11.368
Shpenzimet neto të interesit	5	(21.855)	(91.867)
Të ardhurat nga provizioni		344.706	305.089
Shpenzimet e provizionit		(21.820)	(16.612)
Të ardhurat neto nga provizioni	6	322.886	288.477
Kursi neto i perealizuar dhe ndryshimet e çmimeve	7	1.011.378	979.821
Shpenzimet neto nga letrat me vlerë të matura me vlerën objektive përmes raportit të të ardhurave dhe instrumenteve financiare derivative	8	(3.247.087)	(875.490)
Ndryshimet neto të kursit të këmbimit dhe çmimeve të realizuara	9	439.437	292.657
Të ardhura nga dividendët	10	9.230	16.566
Të ardhura të tjera	11	334.760	37.323
Shpenzimet për punonjësit	12	(491.190)	(456.498)
Deprecizimi dhe amortizimi	26,27	(68.239)	(66.544)
Shpenzime të tjera	13	(199.800)	(162.156)
Ndarja e një rezerve të veçantë dhe korigjimi i vlerës dhe zhvlerësim/ lirim i korigjimit të vlerës, neto	14	(156.394)	5.247
Humbje neto për vitin		(2.066.874)	(32.464)

RAPORTI I TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

	2022	2021
Humbja neto për vitin nga raporti i të ardhurave	(2.066.874)	(32.464)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		
- Ndryshimet neto të perealizuara në vlerën objektive të letrave me vlerë të kapitalit të matura nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse	502	-
- Fitimet nga donacionet e pranuar të librave - fondi i bibliotekës	11	39
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	513	39
Humbja gjithëpërfshirëse totale për vitin	(2.066.361)	(32.425)

Raporti financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë MKD, përderisa nuk është përcaktuar ndryshe)***RAPORTI I GJENDJES FINANCIARE**

MJETE	Shënim	31 dhjetor	
		2022	2021
Paratë e huaja efektive	15	2.964.247	3.372.659
Depozita në valutë të huaj	16	53.654.174	41.819.630
Letra me vlerë të huaja	17	157.847.953	157.372.715
Instrumentet derivative	18	-	-
Ar	19	23.155.343	21.923.813
E drejta e tërheqjes speciale	20	24.679	80.443
Kërkesa në bazë të transaksioneve të repove në valutë	21	8.902.551	2.127.117
Kërkesa nga shteti për marrëdhëniet me FMN-në	22	32.643.436	25.948.414
Anëtarësimi në FMN	23	11.070.941	10.234.301
Kreditë e dhëna ndaj bankave	24	-	-
Kërkesa të tjera	25	-	-
Kërkesat e bankave		-	-
Pasuri të paluajtshme dhe pajisje	26	1.501.281	1.452.612
Aktivët e patrupëzuara	27	28.274	31.961
Monedha nga metale të çmuara	28	5.815	5.703
Kërkesa nga puna	29	111.103	32.894
Mjete të tjera	30	221.203	137.716
Gjithsej mjete		292.131.000	264.539.978

Raporti financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë MKD, përderisa nuk është përcaktuar ndryshe)

RAPORTI I GJENDJES FINANCIARE (vazhdon)

DETYRIMET DHE KAPITALI	Shënim	31 dhjetor	
		2022	2021
Para të gatshme në qarkullim	31	53.852.538	51.392.438
Depozita në banka dhe në kursimore	32	74.295.265	74.060.754
Rezerva e detyrueshme e bankave në valutë të huaj dhe rezerva e detyrueshme e kursimoreve në denarë	33	27.148.967	19.960.662
Bonot e thesarit të Bankës Popullore	34	9.450.579	9.993.065
Detyrimet e bazuara në transaksionet e repove në valutë	35	27.355.608	8.363.671
Depozitat në denarë të shtetit	36	23.983.580	24.919.606
Depozitat në valutë të huaj të shtetit	37	16.360.703	22.067.344
Depozitat e shtetit		40.344.283	46.986.950
Depozita të kufizuara	38	142.111	137.929
Detyrimet në bazë të ndarjes së SPV-së - në emër dhe në llogari të shtetit	39a	15.339.855	15.242.012
Detyrimet në bazë të kredive të përdorura nga FMN-ja, në emër dhe në llogari të shtetit	39b	17.303.581	10.706.402
Detyrimet në bazë të anëtarësimit dhe depozitave	39c	11.070.941	10.234.301
Detyrimet ndaj FMN-së	39	43.714.377	36.182.715
Depozita të tjera	40	2.762.513	2.333.764
Rezerva e veçantë	41	344	322
Detyrime të tjera	42	563.999	560.931
Detyrime të tjera		564.343	561.253
Totali i detyrimeve		279.630.584	249.973.201
Kapitali		1.289.789	1.289.789
Rezervat e përgjithshme		432.826	1.334.893
Rezerva e veçantë		843.987	843.987
Rezervat e rivlerësimit		9.933.814	11.098.108
Kapitali dhe rezervat totale	43	12.500.416	14.566.777
Kapitali dhe rezervat totale		292.131.000	264.539.978

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Raporti financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë MKD, përderisa nuk është përcaktuar ndryshe)

RAPORTI I NDRYSHIMIT NË KAPITAL								
	Shëni m	Kapital	Rezervat e përgjithshme	Rezerva e veçantë	Rezervat e rivlerësimit Rezervat e rivlerësimit **	Rezervat e rivlerësimit Veprat e artit dhe koleksioni i bibliotekës	Fitimi/humbja e grumbulluar	Kapitali dhe rezervat totale
Gjendja më 1 janar 2021		1.289.789	1.326.756	717.417	11.307.313	4.035	-	14.645.310
Humbje për vitin		-	-	-	-	-	(32.464)	(32.464)
Fitimi nga librat e pranuar, donacionet - fondi i bibliotekës	43	-	-	-	-	39	-	39
Humbje totale për vitin 2021		-	-	-	-	39	(32.464)	(32.425)
Ndryshimet e kursit pozitiv neto të parealizuar të këmbimit dhe çmimi i arit që janë lënë mënjanë në rezervat e rivlerësimit	43	-	-	-	850.039	-	(850.039)	-
Diferencat neto pozitive të parealizuar të kursit të këmbimit që janë lënë mënjanë në rezervat e rivlerësimit	43	-	-	-	129.782	-	(129.782)	-
Ndryshimet neto pozitive të parealizuar të çmimeve për HV-në që janë lënë mënjanë në rezervat e rivlerësimit	43	-	-	-	7	-	(7)	-
Ndryshimet neto të çmimeve negative të parealizuar për HV-në që mbulohen nga rezervat e rivlerësimit	43	-	-	-	(74.897)	-	74.897	-
Ndryshime të realizuara të kursit dhe çmimit të arit	43	-	-	-	(1.070.362)	-	1.070.362	-
Ndryshime të realizuara të çmimeve për HV-në	43	-	-	-	(47.848)	-	47.848	-
Shpërndarja në rezerva të përgjithshme	43	-	8.137	-	-	-	(8.137)	-
Shpërndarja në rezervat speciale me qëllim të veçantë	43	-	-	126.570	-	-	(126.570)	-
Ndarje në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut	42	-	-	-	-	-	(46.108)	(46.108)
Gjendja më 31 dhjetor 2021		1.289.789	1.334.893	843.987	11.094.034	4.074	-	14.566.777
Gjendja më 1 janar 2022		1.289.789	1.334.893	843.987	11.094.034	4.074	-	14.566.777
Humbje për vitin		-	-	-	-	-	(2.066.874)	(2.066.874)
Ndryshimet neto pozitive të parealizuar të çmimeve për HV të matura me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse që janë lënë mënjanë në rezervat e rivlerësimit	43	-	-	-	502	-	-	502
Fitimi nga librat e pranuar, donacionet - fondi i bibliotekës	43	-	-	-	-	11	-	11
Humbje totale për vitin 2022		-	-	-	502	11	(2.066.874)	(2.066.361)
Ndryshimet e kursit pozitiv neto të parealizuar të këmbimit dhe çmimi i arit që janë lënë mënjanë në rezervat e rivlerësimit	43	-	-	-	1.061.491	-	(1.061.491)	-
Diferencat neto të parealizuar negative të këmbimit që mbulohen nga rezervat e rivlerësimit	43	-	-	-	(50.113)	-	50.113	-
Ndryshimet neto pozitive të parealizuar të çmimeve për HV që janë lënë mënjanë në rezervat e rivlerësimit	43	-	-	-	32.296	-	(32.296)	-
Ndryshimet neto të çmimeve negative të parealizuar për HV që mbulohen nga rezervat e rivlerësimit	43	-	-	-	(11.442)	-	11.442	-
Ndryshime të realizuara të kursit dhe çmimit të arit	43	-	-	-	(2.191.440)	-	2.191.440	-
Ndryshime të realizuara të çmimeve për HV	43	-	-	-	(5.599)	-	5.599	-
Mbulimi i rezultatit neto negativ të shpërndarjes	43	-	(902.067)	-	-	-	902.067	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022		1.289.789	432.826	843.987	9.929.729	4.085	-	12.500.416

* Të përcaktuara si llogari rezervë speciale në Ligjin e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

** Përcaktuar si llogari të rezervave të rivlerësimit në Ligjin e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
Raporti financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë MKD, përderisa nuk është përcaktuar ndryshe)

RAPORT I FLUKSEVE MONETARE			
	Shënim	2022	2021
Flukset monetare nga aktivitetet operative			
Humbje për vitin		(2.066.874)	(32.464)
Korrigjuar për:			
Të ardhurat nga interesi	5	(497.572)	(97.272)
Shpenzimet e interesit	5	538.498	200.507
Efektet e interesit negativ	5	(19.071)	(11.368)
Kursi neto i parealizuar i këmbimit dhe ndryshimet e çmimeve nga ari		(1.263.020)	(883.240)
Shpenzimet neto nga letrat me vlerë të matura me vlerën e drejtë përmes raportit të të ardhurave		3.474.633	1.615.420
Të ardhura nga dividendët		(9.230)	(16.566)
Korrigjimi i vlerës dhe korrigjimi i zhvlerësimit / (lëshimit) të vlerës		156.322	(5.268)
Rezervë e veçantë e ndarë		22	75
Deprecizimi dhe amortizimi	26, 27	68.239	66.544
Flukset monetare nga aktivitetet operative, përpara ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative		381.947	836.368
Ar		38.848	4.915
Letrat me vlerë të huaja		(3.904.086)	(3.028.543)
Kërkesat e bazuara në transaksionet e repove në valutë		(6.770.028)	(2.127.896)
Kërkesat nga shteti për marrëdhëniet me FMN-në		(6.453.701)	(9.204.230)
Mjete të tjera		(248.403)	78.862
Para të gatshme në qarkullim		2.460.100	1.352.494
Depozitat e bankave dhe kursimore		232.579	5.410.512
Rezerva e detyrueshme e bankave në valutë dhe rezerva e detyrueshme e kursimoreve në denarë		7.188.305	2.561.961
Bono thesari të Bankës Popullore, hyrje		99.140.328	119.867.110
Bono thesari të Bankës Popullore, dalje		(99.879.000)	(120.000.000)
Detyrimet e bazuara në transaksionet e repove në valutë		18.985.279	8.366.448
Depozitat shtetërore duke përfshirë depozitat e kufizuara dhe të tjera		(6.210.149)	835.613
Detyrimet në bazë të kredive të përdorura nga FMN-ja në emër dhe në kurriz të shtetit		6.453.701	-
Detyrime të tjera		(21.243)	(20.560)
Detyrimet në bazë të ndarjes së SPV-së - në emër dhe në kurriz të shtetit		-	10.243.548
Interesi i marrë		440.217	214.511
Interesi i paguar		(314.238)	(56.983)
Dividentët e pranuar		9.230	16.566
Flukset neto monetare nga aktivitetet operative		11.529.686	15.350.696
Blerjet e pasurive të paluajtshme, pajisjeve dhe mjeteve të pamaterializuara		(113.210)	(249.595)
Flukset neto monetare të përdorura në aktivitetet investuese		(113.210)	(249.595)
Fitimi i paguar në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut		(46.108)	(32.618)
Flukset neto monetare të përdorura për aktivitetet financiare		(46.108)	(32.618)
Rritje neto në para dhe mjeteve monetare		11.370.368	15.068.483
Para dhe mjete monetare në fillim të vitit		45.272.732	30.204.249
Para dhe mjete monetare në fund të vitit	44	56.643.100	45.272.732

1. Informacione të përgjithshme

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) është banka qendrore e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe është institucioni i vetëm emetues në vend. Banka Popullore, si bankë qendrore emetuese, u themelua në vitin 1992. Organizimi dhe funksionimi i Bankës Popullore rregullohen me Ligjin e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10 si bankë qendrore emetuese, u themelua në vitin 1992. Organizimi dhe funksionimi i Bankës Popullore rregullohen me Ligjin e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, nga 9 dhjetori 2010, nr. 123/12, nga 2 tetori 2012, nr. 43/14, nga 4 marsi 2014, nr. 153/15, nga 4 shtatori 2015, nr. 6/16, nga 15 janari 2016, nr. 83/18 nga 8 maji 2018 dhe në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21 nga 19 maji 2021. Banka Popullore është person juridik me pavarësi administrative, financiare dhe menaxheriale dhe është e autorizuar për arritjen e qëllimeve dhe kryerjen e detyrave të përcaktuara me ligj.

Sipas Ligjit të Bankës Popullore, qëllimi kryesor i Bankës Popullore është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Qëllimi tjetër, i cili i nënshtrohet objektivit parësor, është të kontribuojë në ruajtjen e sistemit financiar të qëndrueshëm dhe konkurrues, të orientuar nga tregu. Objektivi i tretë i Bankës Popullore është të mbështesë politikën e përgjithshme ekonomike, pa rrezikuar arritjen e qëllimit të saj kryesor dhe në pajtim me parimin e ekonomisë së tregut të hapur me konkurrencë të lirë.

Banka Popullore në afat prej katër muajsh pas përfundimit të vitit financiar publikon dhe ia dorëzon Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministrit të Financave një ose më shumë raporte të miratuara nga Këshilli i Bankës Popullore, në lidhje me kushtet dhe lëvizjet në ekonomi për vitin e mbyllur dhe perspektivat për vitin e ardhshëm, me referencë të veçantë për realizimin e synimeve dhe politikave të Bankës Popullore, si dhe gjendjen e sistemit bankar dhe stabilitetin financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në të njëjtën periudhë, i dorëzon edhe raportet vjetore financiare për vitin financiar që ka përfunduar, të miratuara nga Këshilli i Bankës Popullore, të nënshkruara nga guvernatori dhe të vërtetuara nga auditori i jashtëm i pavarur deri te presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministri i Financave.

Kapitali i Bankës Popullore është në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ai nuk mund të transferohet apo të jetë subjekt i ndonjë barre. Fitimi ose humbja neto e Bankës Popullore përcaktohet në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Rezultati financiar për shpërndarje përcaktohet kur shuma totale e të ardhurave të përcaktuara nga rivlerësimi zbritet nga fitimi/humbja neto (kjo shumë transferohet në tërësi në llogaritë e rezervës së rivlerësimit) dhe shtohet shuma e të ardhurave të realizuara në vitin për të cilin janë lënë nën rezervat e rivlerësimit në periudhat e kaluara (kjo shumë zbritet nga llogaritë e rezervës së rivlerësimit). Shpenzimet e përcaktuara të rivlerësimit mbulohen nga llogaritë përkatëse të rezervës së rivlerësimit derisa gjendja e këtyre llogarive të zvogëlohet në zero, dhe më pas nga fitimi i realizuar në vitin aktual, nga llogaria e rezervës së përgjithshme dhe nga kapitali.

1. Informacione të përgjithshme (vazhdon)

Rezultati financiar për shpërndarje, shpërndahet në rezervat e përgjithshme dhe në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht: 70% në rezervën e përgjithshme deri në arritjen e nivelit të kapitalit bazë të përcaktuar me Ligjin e Bankës Popullore, gjegjësisht 15% në rezervat e përgjithshme pas arritjes së nivelit të kapitalit bazë të përcaktuar me Ligjin e Bankës Popullore. Pjesa tjetër janë të ardhura për Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në rastin e llogarisë së hapur për rezerva speciale, rezultati financiar për shpërndarje mund të shpërndahet në mënyrë që maksimumi 70% të transferohet në llogarinë për rezerva speciale deri në arritjen e shumës së përcaktuar nga Këshilli i Bankës Popullore për mbulimin e shpenzimeve për qëllime të paracaktuara, dhe nga pjesa tjetër 70% do të ndahen në rezervat e përgjithshme deri në arritjen e nivelit të kapitalit bazë, gjegjësisht 15% pas arritjes së nivelit të kapitalit bazë dhe pjesa tjetër në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Nëse rezultati financiar për shpërndarjen është negativ, ai fillimisht mbulohet nga rezervat e përgjithshme dhe më pas nga kapitali. Nëse vlera e mjeteve të Bankës Popullore është më e ulët se shuma e detyrimeve dhe kapitalit të saj, mungesa e kapitalit mbulohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në para ose në letra me vlerë të transferueshme të borxhit me maturim të caktuar që emetohen sipas normave të interesit të tregut që mbizotërojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Organi drejtues i Bankës Popullore është Këshilli i Bankës Popullore.

Raportet financiare për vitin financiar 2022 janë miratuar nga Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 27 shkurt 2023 dhe janë nënshkruar nga guvernatorja e Bankës Popullore:

Dr. Anita Angellovska-Bezhoska,

Guvernatorja e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Vesna Filipovska,

Drejtoresha e Drejtorisë së Financave, Kontabilitetit dhe Kontrollës

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël

Politikat bazë kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre raporteve financiare janë paraqitur më poshtë.

A Baza për përgatitjen e raporteve financiare

Raportet financiare janë përgatitur në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), të cilat përfshijnë standardet dhe interpretimet e miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve të Raportimit Financiar (KNIRF).

Raportet financiare përgatiten sipas parimit të vlerës së blerjes si bazë për matje, me përjashtim të disa mjetet të cilat maten sipas vlerës së drejtë. Mjetet e matura me vlerën e drejtë janë: mjetet financiare të vlerësuara me vlerën e drejtë përmes raportit të të ardhurave, mjetet financiare të vlerësuara me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, derivatët financiarë dhe veprat artistike. Prona, pajisjet dhe mjetet e patrupëzuara maten me harxhimet e tyre minus depreciimin/amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse egzistojnë.

a) Ndryshimet në mjedis

Presionet inflacioniste që filluan në fund të vitit 2021 me ndërprerjen e zinxhirëve të furnizimit global dhe rritjen e kërkesës pas pandemisë janë intensifikuar ndjeshëm në vitin 2022 nën ndikimin e rritjes shtesë dhe jashtëzakonisht të lartë të çmimeve të ushqimeve, mallrave dhe energjisë, si rezultat i luftës në Ukrainë. Në rrethanat¹ e reja, bankat qendrore të ekonomive kryesore në vitin 2022 nisën normalizimin e politikës monetare dhe rritën në disa raste normat e interesit referencë. Gjegjësisht, në vitin 2022, FED-i² rriti në disa raste normën e interesit referencë në total prej 425 pikë bazë³, ndërsa Banka Qendrore Europiane (BQE) rriti katër herë normën e interesit referencë, duke e çuar atë nga 0% në fund të 2021, në 2,5% në fund të 2022. Rritja e intensifikuar e normave të interesit dhe angazhimet e autoriteteve monetare për shtrëngim të mëtejshëm të ndjeshëm të politikës monetare, shkaktuan rritje të ardhurave të instrumenteve me të ardhura fikse në tregjet e huaja, për të cilën

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

A Baza për përgatitjen e raporteve financiare (vazhdon)

a) Ndryshimet në mjedis (vazhdon)

¹ Në vitin 2022, në nivel global, u regjistrua inflacioni më i lartë në dyzet vitet e fundit.

² Sistemi i Rezervës Federale (Federal Reserve Bank of New York) – FED, është sistemi i bankave qendrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

³ Shtrirja totale e normës së interesit të FED-it në fund të vitit 2021 ishte 0% – 0,25%, ndërsa në fund të vitit 2022 ishte 4,25 – 4,5%.

obligacionet më të sigurta në eurozonë tejkaluan 300 pikë bazë në bazë vjetore, disa herë më shumë se rritja në 2021⁴.

Mjedisi ndërkombëtar pati ndikim të madh në ekonominë e brendshme dhe për rrjedhojë, reagimi ndaj politikës monetare të Bankës Popullore nuk ndryshonte ndjeshëm nga drejtimi i politikave të bankave qendrore më me ndikim. Në përgjigje të lëvizjeve rritëse të pritjeve inflacioniste, Banka Popullore filloi cikël shtrëngimi të politikës monetare nga fundi i vitit 2021, me qëllim ruajtjen e stabilitetit të kursit të këmbimit dhe stabilizimin e inflacionit në afat të mesëm. Konkretisht, rritja e kërkesës për valutë në radhë të parë nga sektori i korporatave, veçanërisht nga aktivitetet energjetike, kontribuoi në praninë më të shpeshtë të Bankës Popullore me ndërhyrje për shitjen e valutës që ndikoi në uljen e mjeteve të tepërta likuide në sistemin bankar. Në kushtet e rritjes së kërkesës në tregun valutor, Banka Popullore mbajti rezerva valutore në instrumente me likuiditet të lartë. Nga prilli 2022, Banka Popullore ka rritur normën e interesit edhe për instrumentin bazë të politikës monetare, bonot e thesarit, në disa raste, me çka në fund të vitit 2022 arriti në 4,75%. Shuma e ofruar e bonove të thesarit mbeti e pandryshuar në 10.000.000 mijë denarë. Njëkohësisht, u rritën edhe normat e interesit për depozitat njëditore dhe ato shtatëditore, me 2, 50 p.p. secila dhe 2,40 p.p., përkatësisht, në nivelet 2,65% dhe 2,70%, përkatësisht.

Ndryshime të tilla në pozicionimin e politikës monetare çuan në një rritje të ndjeshme të harxhimeve monetare në krahasim me vitin 2021, kur Banka Popullore, në kuadër të veprimtarisë së saj, për të mbështetur ekonominë vendase për të zbutur pasojat e shkaktuara nga pandemia e kovid-19, uli normën bazë të interesit, e cila më 31.12.2021 ishte 1,25%. Shuma e bonove të thesarit gjatë gjithë vitit 2021 ishte në nivelin prej 10.000.000 mijë denarë, që korrespondonte me vlerësimet e pozicionit adekuat të likuiditetit të bankave. Në të njëjtën kohë, u bënë ndryshime në rezervën e detyrueshme, e cila çliroi likuiditet shtesë për mbështetje më të madhe të kreditimit të sektorëve më të prekur të ekonomisë.

Banka Popullore në vitin 2021 dhe 2022 ka vazhduar të zbatojë masën jostandarde për rezervën e detyrueshme, me të cilën pretendimet e bazuara në kreditë e reja ose të ristrukturuara të miratuara për kompanitë jofinanciare nga sektorët më të prekur nga pandemia e kovid-19 u përjashtuan nga baza për rezervën e detyrueshme

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

A Baza për përgatitjen e raporteve financiare (vazhdon)

a) Ndryshimet në mjedis (vazhdon)

rezervë gjatë gjithë vitit që nga periudha e rezervës së detyrueshme të janarit në vitin 2023, pas së cilës skadoi vlefshmëria e kësaj mase.

⁴ Që në fund të vitit 2021, pjesëmarrësit e tregjeve financiare ndërkombëtare forcuuan pritshmëritë për normalizimin e politikave monetare të bankave qendrore kryesore, në mënyrë që të ardhurat e obligacioneve të qeverisë në SHBA të shënuan një rritje të dukshme (pikë bazike 60 – 80), ndërkohë që rritja e të ardhurave të obligacioneve më të sigurta të qeverisë nga Eurozona ishte më e moderuar (rreth 20 pikë bazike dhe dy herë më e lartë ishte rritja e të ardhurave të obligacioneve që përmbajnë një premi kredie), për shkak të pritjeve për një rregullim më të ngadaltë të politikës monetare nga Banka Qendrore Europiane.

Për një veprim më të synuar në procesin e denarizimit, në vitin 2022 Banka Popullore bëri ndryshime në instrumentin e rezervës së detyrueshme, me të cilin norma e rezervës së detyrueshme për detyrimet në denarë u ul nga 8% në 5%, ndërsa në të njëjtën kohë norma e rezervës së detyrueshme për detyrimet në valutë u rrit nga 15% në 19%. Në të njëjtën kohë është rritur edhe pjesa e rezervës së detyrueshme e llogaritur nga detyrimet valutores e cila plotësohet në euro (nga 70% në 77%). Me këto ndryshime, Banka Popullore rriti hapësirën për ndryshime në politikat e interesit të bankave në favor të produkteve të depozitave në denarë dhe rriti atraktivitetin e kursimeve në denarë, përmes rritjes së kthimit nga këto produkte bankare. Krahas këtyre masave, në vitin 2022 Banka Popullore filloi zbatimin e një mase të re jo standarde për rezervën e detyrueshme, për të nxitur kreditimin e projekteve që kanë të bëjnë me prodhimin vendas të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme. Masa përfshin zvogëlimin e bazës për rezervën e detyrueshme në denarë për shumën e kërkesave në bazë të kredive të miratuara rishtazi për financimin e projekteve për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të ripërtëritshme. Kjo masë mbështet "financat e gjelbra" dhe financimin e qëndrueshëm, si synim strategjik në planin e fundit strategjik të Bankës Popullore. Në të njëjtën kohë, Banka Popullore po përpiket të kontribuojë në zbutjen e presioneve dhe problemeve strukturore në ekonomi, duke pasur parasysh krizën energjetike dhe priren e rritjes globale të çmimit të energjisë elektrike që filloi në fund të vitit 2021.

Rrethanat e tilla u reflektuan në gjendjen financiare të Bankës Popullore.

Harxhimet e politikës monetare gjatë vitit 2022 patën një realizim dukshëm më të lartë krahasuar me vitin 2021, si rezultat i rritjes së normave të interesit dhe zbatimit të instrumenteve monetare.

Nga ana tjetër, të ardhurat monetare në vitin 2022 u ndikuan nga luhatshmëria e kthimeve në tregjet e huaja dhe kurset e këmbimit, të cilat kufizuan mundësitë për investime afatgjata, si dhe diversifikimin valutor të rezervave valutores. Rritja e të ardhurave si në vitin 2021 ashtu edhe në vitin 2022 shkaktoi një rënie të përkohshme të vlerës së tregut të letrave me vlerë me të ardhura fikse të matura me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes, e cila së bashku me kthimin negativ nga blerja, në masën më të madhe përcaktoi rezultatin financiar të investimeve të mjeteve valutores të Bankës Popullore. Për shkak të rritjes jashtëzakonisht të lartë të fitimit në vitin 2022, ky efekt ishte dukshëm më i lartë krahasuar me vitin 2021. Nga ana tjetër, qasja aktive në administrimin e rezervave valutores ka pasur efekt të favorshëm për realizime më pak negative dhe ka ndikuar për tejkalim të moderuar të rezultateve të portofoleve të tregtimit në raport me portofolet referente përkatëse, e cila ishte për shkak të zgjedhjes së instrumenteve, pra instrumenteve me fitim më të lartë në të cilat ishin investuar rezervat valutores. Për të kompensuar efektin negativ të rritjes së të ardhurave në rezultatin financiar në vitet 2021 dhe 2022, kanë kontribuar arritjet e favorshme nga menaxhimi aktiv i arit.

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

A Baza për përgatitjen e raporteve financiare (vazhdon)

a) Ndryshimet në mjedis (vazhdon)

Normat pozitive të interesit të depozitave në euro dhe rritja e të ardhurave në vitin 2022, megjithatë ndikuan pozitivisht në investimet e reja në instrumente financiare dhe rrjedhimisht në rezultatet e pritura financiare në vitet në vijim. Gjegjësisht, për herë të parë që nga viti

2014, normat e interesit dhe të ardhurat rrjedhëse deri në maturim të instrumenteve financiare të shprehura në euro janë pozitive, gjë që do ta vendosë Bankën Popullore në një pozitë më të mirë, duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e mjeteve valutore mbahen në euro për shkak të strategjia monetare e mbajtjes stabile të kursit nominal të denarit në raport me euron.

b) Zbatimi fillestar i ndryshimeve të reja në standardet ekzistuese që janë në fuqi në periudhën raportuese

Standardet e reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) që janë në fuqi në periudhën aktuale të raportimit janë:

- **Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e biznesit"** – Ndryshimet në rekomandimet e kuadrit gjithëpërfshirës në SNRF 3 (të aplikueshme për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022);
- **Ndryshimet në SNK 16 "Prona, objektet dhe pajisjet"** – Flukset hyrëse përpara se mjeti të jetë gati për përdorim (të aplikueshme për periudhat vjetore në ose pas datës 1 janar 2022);
- **Ndryshimet në SNK 37 "Rezervimet, detyrimet kontingjente dhe mjetet kontingjente"** – Kontratat e pafavorshme – Harxhimet e performancës së kontratës (e zbatueshme për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022); dhe
- **Ndryshimet në standarde të ndryshme për shkak të "Përmirësimeve në SNRF-i (cikli 2018 – 2020)"** të cilat janë rezultat i projekteve vjetore të përmirësimit të SNRF-së (SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41) kryesisht për të hequr mospajtueshmëritë dhe për të sqaruar tekstin (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9 dhe SNK 41 janë të zbatueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2022. Ndryshimet në SNRF 16 i referohen vetëm shembujve ilustrues, kështu që nuk specifikohet data e hyrjes në fuqi e ndryshimeve).

Ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja nuk kanë sjellë ndonjë ndryshim material në raportet financiare të Bankës Popullore.

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

A Baza për përgatitjen e raporteve financiare (vazhdon)

c) Standarde të reja dhe ndryshime në standardet ekzistuese që nuk kanë hyrë ende në fuqi

Në ditën e publikimit të këtyre raporteve financiare janë publikuar standardet e mëposhtme, shtesat dhe interpretimet e tyre të reja, të cilat ende nuk kanë hyrë në fuqi:

- **SNRF 17 "Kontratat e sigurimit"**– Ndryshimet në SNRF 17 duke përfshirë zgjatjen e përjashtimit të përkohshëm nga zbatimi i SNRF 9 (Ndryshimet në SNRF 4) (i zbatueshëm për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023);
- **Ndryshimet në SNK 8 "Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet"** Përcaktimi i termit "vlerësime kontabël" si dhe ndryshime të tjera në SNK 8 që shpjegojnë diferencat midis ndryshimeve në politikat kontabël kundrejt ndryshimeve në vlerësimet kontabël (e zbatueshme për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023);
- **Ndryshimet në SNK 1 "Prezantimi i raporteve financiare"** – Ndryshimet në paraqitjen e politikave kontabël materiale, në krahasim me politikat kontabël të rëndësishme (të zbatueshme për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023);
- **Ndryshimet në SNK 1 "Prezantimi i raporteve financiare"** – Ndryshimet në seksionin për klasifikimin e detyrimeve si korrente ose afatgjata, duke sqaruar udhëzimin për përcaktimin nëse një detyrim i veçantë është aktual ose jo-korrent (i zbatueshëm për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024);
- **Ndryshimet në SNRF 16 "Qiratë"** – Ndryshimet në trajtimin kontabël të detyrimeve të shitjes dhe marrjes me qira pas datës së transaksionit (e zbatueshme për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024); dhe
- **Ndryshimet në SNK 1 "Prezantimi i raporteve financiare"** – Ndryshime për të përmirësuar paraqitjen e detyrimeve afatgjata me konventa në raportet financiare (e zbatueshme për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024).

Banka Popullore nuk i ka zbatuar këto standarde të reja dhe të ndryshuara dhe interpretime të reja para datës së zbatimit të tyre. Banka Popullore beson se miratimi i këtyre standardeve, ndryshimeve dhe interpretimeve të reja nuk do të ketë ndikim material në raportet financiare të Bankës Popullore gjatë periudhës së zbatimit fillestar të tyre.

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

B Transaksionet në valutë të huaj

Valuta funksionale dhe raportuese

Artikujt e përfshirë në raportet financiare paraqiten në monedhën e mjedisit primar ekonomik në të cilin vepron Banka Popullore (monedhë funksionale). Raportet financiare janë paraqitur në denarë maqedonas (MKD), që është valuta funksionale dhe raportuese e Bankës Popullore, e shprehur në mijë denarë.

Transaksionet dhe gjendjet

Mjetet dhe detyrimet në valutë janë të shprehura në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit në ditën e përpilimit të Raportit për gjendjen financiare, përveç evidencës për kuotën e Republikës së Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në FMN, si dhe si në llogaritë nr. 1 dhe 2 (Shënim 23 dhe 39c). Transaksionet e kryera në valutë të huaj shprehen në denarë me kursin e këmbimit në ditën e transaksionit.

Të gjitha diferencat nga ndryshimet në kursin e këmbimit njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Kursi mesatar i këmbimit:	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
	MKD	MKD
USD	57,6535	54,3736
EUR	61,4932	61,6270
DTS	76,6655	76,1765

C Netingu

Mjetet dhe detyrimet financiare janë neto dhe vlera neto e tyre paraqitet në Raportin e Pozicionit Financiar mbi bazën neto, nëse plotësohen disa kushte të përcaktuara nga një standard i përshtatshëm për neto dhe mundësia e paraqitjes ose shlyerjes së transaksioneve në bazë neto.

Ç Transaksionet repo

Letrat me vlerë të shitura që i nënshtrohen riblerjes (transaksionet repo) riklasifikohen në raportet financiare si mjete që jepen me qira kur transferuesi, sipas kontratës, ka të drejtë ose synon t'i shesë ose t'i rikthejë ato si kolaterale. Detyrimet e bazuara në transaksione repo përfshihen në detyrimet e bazuara në transaksione repo në valutë. Pretendimet e bazuara në letrat me vlerë të blera që janë objekt rishitjeje (transaksione të anasjellta të repove) përfshihen në pretendimet e bazuara në transaksione repo në valutë të huaj dhe huatë e dhëna bankave.

Diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe blerjes përfaqëson interesin dhe llogaritet për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës duke zbatuar metodën e normës efektive të interesit. Nëse ka letra me vlerë që janë subjekt i një huaje, ato paraqiten në raportet financiare në datën e raportimit.

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

D Transaksionet repo (vazhdon)

Letrat me vlerë që janë marrë hua dhe ato që merren si kolateral për transaksionet e anasjellta të repove nuk njihen në raportet financiare, përveç rasteve kur u shiten palëve të treta, në këtë rast blerjet dhe shitjet paraqiten si fitim ose humbje dhe përfshihen në raportin e të ardhurave. në periudhën të cilës i referohen. Detyrimi për të kthyer letrat me vlerë paraqitet me vlerën e drejtë si një detyrim nga operacionet e rregullta. Transaksionet repo paraqiten me harxhime të amortizuara, minus provizionin për humbjet e pritshme të kredisë (shiko shënim 2I).

Transaksionet e arit të kolateralizuara trajtohen si marrëveshje riblerjeje. Detyrimet e bazuara në transaksionet e arit të kolateralizuara përfshihen në detyrimet e bazuara në transaksionet e repove në valutë. Ari që është objekt i kësaj marrëveshjeje vazhdon të prezantohet në raportin për gjendjen financiare të Bankës Popullore dhe vazhdon me rregullimin e çmimit dhe kursit të tij. Diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe blerjes përfaqëson interesin dhe llogaritet për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës duke zbatuar metodën e normës efektive të interesit.

Dh Depozitat në valutë të huaj

Depozitat në valutë të huaj paraqiten me blerje të amortizuara, me zbritje të vlerës për humbjet e pritshme të kredisë (shiko shënimin 2I).

E Ari monetar

Ari monetar përbëhet nga depozitat e arit në bankat korrespondente dhe stoku i shufrave të arit të prodhuara sipas standardeve ndërkombëtare që ruhen në thesarin e Bankës Popullore. Interesi paguhet në dollarë të ShBA-ve ose EUR në datën e caktuar, në varësi të kontratave. Ari monetar është pjesë e rezervave valutore dhe menaxhohet në të njëjtën mënyrë si mjetet e tjera financiare nga rezervat valutore. Ari matet në njësinë matëse të një ons të imët ari.

Ari monetar klasifikohet si një mjet financiar me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, i përcaktuar si i tillë në njohjen fillestare dhe matet me vlerën objektive. Vlera objektive e arit monetar është e lidhur me çmimin e arit dhe llogaritet në bazë të çmimit të tregut para mesditës për 1 ons ari në bursën e arit në Londër, e shprehur në dollarë amerikanë, e shprehur në MKD me kursin aktual të këmbimit prej MKD ndaj dollarit amerikan në datën e raportit financiar. Fitimet dhe humbjet e realizuara dhe të porealizuara nga rivlerësimi i arit në fund të periudhës kontabël që rezultojnë nga ndryshimet në çmimin e tregut të arit dhe ndryshimi i kursit të denarit kundrejt dollarit amerikan, përfshihen në raportin e të ardhurave. Interesi për arin monetar përfshihet në të ardhurat nga interesi.

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

Ë Paratë dhe mjetet monetare

Për qëllime të Raportit së Flukseve të Parasë, paratë dhe mjetet monetare përfshijnë shuma me maturim më të vogël se 90 ditë nga data e blerjes, duke përfshirë depozitat në valutë të

huaj, duke përjashtuar depozitat e kufizuara, valutën e huaj në thesarin e Bankës Popullore dhe mjetet me të drejta të veçanta tërheqjeje (në tekstin e mëtejme DTS-ja⁵) në llogarinë speciale në FMN-në.

F Mjete financiare

Klasifikimi dhe matja e mjeteve financiare

Banka Popullore i klasifikon mjetet financiare në tri kategori, përkatësisht: mjetet financiare të matura me çmimin e blerjes të amortizuar, mjetet financiare të matura me vlerën e drejtë përmes të ardhurave tjera përmbledhëse dhe mjetet financiare të matura me vlerën e drejtë përmes raportit të të ardhurave. Banka Popullore përcakton klasifikimin e mjeteve financiare në varësi të modelit të biznesit dhe flukseve monetare kontraktuale që priten prej tyre.

Modeli i biznesit përfaqëson një mënyrë të menaxhimit të mjeteve financiare në mënyrë që të gjenerohen flukse monetare ose të arrihet një qëllim specifik i biznesit. Menaxhimi strategjik i Bankës Popullore përcakton modelin e biznesit në nivel të grupeve të mjeteve financiare që menaxhohen për të arritur një qëllim specifik të biznesit.

Analiza e karakteristikave të flukseve monetare kontraktuale të mjeteve financiare zbatohet në nivelin e instrumenteve financiare individuale (kushtet kontraktuale) për të kontrolluar nëse flukset monetare kontraktuale nga mjetet lidhen ekskluzivisht me pagesën e "kryegjësë dhe interesit". Brenda flukseve monetare kontraktuale, elementi "kryegjësë" përfshin shumën në miratimin fillestar, minus çdo ripagesë; ndërsa elementi "interesi" përfaqëson kompensimin për vlerën në kohë të parasë, rrezikun e kredisë, rrezikun e likuiditetit, harxhimet administrative ose të shërbimit dhe marzhin e fitimit.

Banka Popullore menaxhon mjetet financiare përmes modeleve të mëposhtme të biznesit:

- Modeli i biznesit qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve me qëllim të mbledhjes së flukseve monetare kontraktuale;
- Modele të tjera biznesi (tregtimi dhe realizimi i fitimeve nga ndryshimi i vlerës së drejtë të mjeteve); dhe
- Modeli i biznesit qëllimi i të cilit është mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e mjeteve financiare.

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

G Mjete financiare (vazhdon)

Klasifikimi dhe matja e mjeteve financiare (vazhdon)

Mjetet financiare të matura me kosto të amortizuar

⁵ Special Drawing Rights.

Mjetet financiare të matura me koston e amortizuar janë investime që synojnë të sigurojnë mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe nga të cilat banka pret vetëm mbledhjen e "kryegjësë dhe interesit". Kjo kategori përfshin letrat me vlerë të borxhit të matura me kosto të amortizuar, huatë dhe të arkëtueshme me pagesa fikse ose të parashikueshme që nuk kuotohen në tregjet aktive.

Letrat me vlerë të borxhit të matura me koston e amortizuar, pas njohjes fillestare, paraqiten më pas me koston e amortizuar minus provizionin për humbjet e pritshme të kredisë. Kostoja e amortizuar është e barabartë me shumën në njohjen fillestare, minus shlyerjet e kryegjësë, e rritur ose ulur nga amortizimi kumulativ duke përdorur metodën e normës efektive të interesit të çdo difference midis shumës fillestare dhe shumës në maturim.

Huatë dhe të arkëtueshmet lindin nga aktivitetet ku Banka Popullore i jep para një debitori pa synimin e tregtimit. Huatë njihen kur mjetet i miratohen debitorit dhe tregohen me kosto të amortizuar duke përdorur parimin e normës efektive të interesit. Në këtë kategori të mjeteve financiare klasifikohen paratë efektive të huaja, depozitat në valutë, të drejtat e veçanta të tërheqjes, të arkëtueshmet në bazë të transaksioneve repo, të arkëtueshmet nga shteti në raport me FMN-në, të arkëtueshmet nga bankat dhe të arkëtueshme të tjera. Për mjetet financiare të matura me kosto të amortizuar, llogaritet një humbje e pritshme kreditore (Shënim 2I).

Letrat me vlerë të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Mjetet financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse janë investime me qëllim mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe/ose mbahen për shitje dhe sipas kushteve kontraktuale parashikojnë flukse monetare ekskluzivisht të "kryegjësë dhe interesit". Letrat me vlerë të kësaj kategorie njihen me vlerën e drejtë dhe ndryshimet në vlerën e drejtë paraqiten si një komponent i veçantë i të ardhurave të tjera përmbledhëse dhe njihen në kapital dhe rezerva, brenda llogarive për rezervat e rivlerësimit. Pas nxjerrjes jashtë përdorimit ose zvogëlimit të vlerës bazuar në njohjen e një provizioni për humbjen e pritshme të kredisë, fitimet dhe humbjet e akumuluar të shprehura në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe të shpërndara në kapital dhe rezerva përfshihen në raportin e të ardhurave për periudhën me të cilën ato lidhen. Me gjendjen e 31 dhjetorit 2022 dhe 2021, Banka Popullore nuk ka asnjë investim në letrat me vlerë të borxhit të kësaj kategorie.

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

Gj Mjete financiare (vazhdon)

Klasifikimi dhe matja e mjeteve financiare (vazhdon)

Letrat me vlerë të matura me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera përmbledhëse (vazhdon)

Për investimet në instrumente pronësore të disa institucioneve financiare specifike, për të cilat nuk ka treg aktiv dhe zotërimi i të cilave përcaktohet me rregullore dhe/ose lidhet me mundësinë e përdorimit të shërbimeve të ofruara nga këto institucione, mund të konsiderohet se vlera e tyre e blerjes pasqyron vlerën e drejtë të tyre. Për investimet në instrumente pronësore për të cilat nuk ka treg aktiv, por për të cilat mund të përcaktohet një vlerë

objektive, përcaktohet duke zbatuar teknikat e vlerësimit. Këto investime klasifikohen si mjete financiare që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.

Mjetet financiare që maten sipas vlerës së drejtë përmes raportit të të ardhurave

Mjetet financiare që maten sipas vlerës së drejtë përmes raportit të të ardhurave janë investime për qëllime të tregtimit të tyre dhe realizimit të fitimeve nga ndryshimet në vlerën e drejtë të këtyre instrumenteve dhe ato letra me vlerë që nuk plotësojnë kriteret e dy kategorive të tjera. Këto letra me vlerë të borxhit dhe derivativët financiarë vlerësohen me vlerën e drejtë dhe ndryshimet në vlerën e drejtë përfshihen në raportin e të ardhurave.

Njohja fillestare

Të gjitha mjetet financiare njihen fillimisht sipas çmimit të tyre të blerjes, respektivisht vlerës së drejtë të mjeteve të dhëna në momentin e blerjes së tyre, duke përfshirë të gjitha kostot që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit (me përjashtim të derivativëve financiarë dhe letrave me vlerë të matura me vlerën e drejtë përmes raportit të të ardhurave dhe shpenzimeve për të cilat të gjitha kostot njihen në raportin e të ardhurave).

Riklasifikimi i mjeteve financiare të borxhit nga një kategori në tjetrën është i mundur vetëm nëse ka një ndryshim në modelin e biznesit për menaxhimin e mjeteve. Pritet që riklasifikimet do të përfaqësojnë raste të rralla dhe do të bëhen kur ndryshimi në modelin e biznesit ka një ndikim të rëndësishëm në operacionet e biznesit të bankës, ndryshimi është për shkak të një ndryshimi të faktorëve të jashtëm ose të brendshëm që kanë një ndikim të rëndësishëm në aktivitetet, etj.

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

H Vlera objektive

Për investimet në instrumente financiare të tregtuara në tregjet financiare, vlera e drejtë përcaktohet nëpërmjet çmimeve të kuotuar të tregut. Për investimet e pakutuara, vlera e drejtë përcaktohet nëpërmjet çmimeve të tregut të investimeve të ngjashme, ose bazohet në flukset monetare të pritshme të skontuara.

I Korrigjimi i vlerës dhe mosarkëtueshmëria e mjeteve financiare

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë për mjetet financiare të matura me koston e amortizuar (depozita në bankat e huaja, letrat me vlerë të borxhit, të arkëtueshmet në bazë të transaksioneve repo, të arkëtueshmet, huatë dhe paradhëniet) vlerësohet në baza të rregullta dhe shuma e humbjeve të pritshme të kredisë. Humbja e pritshme e kredisë përcaktohet gjithashtu për mjetet financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse.

Për investimet në instrumentet e kapitalit neto që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse, humbja e pritshme e kredisë nuk matet.

Humbja e pritshme e kredisë përfaqëson një shumë të barabartë me diferencën midis flukseve monetare kontraktuale të mjetit financiar dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të pritshme

të mjetit financiar, të skontuar duke zbatuar normën efektive të interesit të përcaktuar në njohjen fillestare të mjetit.

Në datën e raportimit për mjetet financiare, vlerësohet rreziku i kredisë, si dhe nëse ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare e tyre. Bazuar në këto kritere, mjetet klasifikohen në një nga tre nivelet e rrezikut të kredisë. Për çdo mjet financiar të matur me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse, përcaktohet një shumë e korigjimit të vlerës për humbjen e pritshme të kredisë, që korrespondon me nivelet e rrezikut të kredisë në të cilat klasifikohet mjeti.

Niveli 1: humbja e pritshme e kredisë – 12 muaj

Për mjetet financiare ku nuk ka pasur rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare dhe që në datën e raportimit kanë një rrezik të ulët kredie, njihet një humbje e pritshme kredie, e cila përfaqëson një pjesë të humbjes për të gjithë jetëgjatësinë e mjeteve që do të ndodhte si rezultat i probabilitetit të shfaqjes së një ngjarje të padëshiruar brenda 12 muajve të ardhshëm.

Niveli 2: humbja e pritshme e kredisë për të gjithë jetëgjatësinë e mjetit - nuk ka dëshmi objektive të zhvlerësimit (humbje kredie)

Për mjetet financiare ku ka një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare, por nuk janë zhvlerësimit i kredisë, një humbje e pritshme kredite njihet për të gjithë jetën e mbetur të mjeteve.

Niveli 3: humbja e pritshme e kredisë për të gjithë jetëgjatësinë e mjetit – ka dëshmi objektive të zhvlerësimit (humbje kredie)

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

J Korrigjimi i vlerës dhe mosarkëtueshmëria e mjeteve financiare (vazhdon)

Mjetet financiare vlerësohen si kredi të zhvlerësuar si rezultat i ndodhjes së një ose më shumë ngjarjeve që kanë një ndikim të dëmshëm në flukset monetare të ardhshme të vlerësuar të mjeteve.

Konsiderohet se rreziku i mosrealizimit ndodh në rast vonese më të gjatë se 90 ditë dhe banka i klasifikon ato mjete financiare në nivelin 3. Këto të arkëtueshme regjistrohen në llogaritë për të arkëtueshmet e dyshimta dhe të kontestuar. Rregullimi i vlerës njihet për të gjitha kërkesat e regjistruara në regjistrat kontabël që rezultojnë prej tij (kërkesa për: borxhin kryesor, interesin, gjobën e interesit, kërkesat e tjera dhe të ngjajshme.).

Humbja e pritshme e kredisë llogaritet si produkt i ekspozimit të emetuesit/palës në rast mospagimi, humbjes që do të ndodhë në rast mospagimi dhe probabilitetit të mospagimit, skontuar me normën efektive të interesit të përcaktuar në njohjen fillestare. Probabiliteti i dështimit varet nga vlerësimi mesatar i kredisë afatgjatë i instrumenteve: sa më i ulët të jetë vlerësimi i kredisë, aq më i lartë është probabiliteti i mospagimit.

K Kontabiliteti i datës së tregëtisë dhe shlyerjes

Të gjitha blerjet dhe shitjet e rregullta të mjeteve financiare njihen në datën e shlyerjes, domethënë në datën në të cilën mjeti është marrë ose i është dorëzuar një personi tjetër. Blerjet ose shitjet e rregullta janë blerje ose shitje të mjeteve financiare që kërkojnë dorëzimin

e mjeteve brenda një periudhe të caktuar, e cila kryesisht përcaktohet me anë të një kuadri ligjor ose një konvente tregu.

L Mjetet afatgjata të mbajtura për shitje dhe grupi i nxjerrjes jashtë përdorimit

Mjetet afatgjata të mbajtura për shitje dhe grupi i nxjerrjes jashtë përdorimit klasifikohen si të tilla nëse vlera kontabël e tyre pritët të rikuperohet nëpërmjet shitjes dhe jo nëpërmjet përdorimit të vazhdueshëm.

Mjetet afatgjata (ose grupi i nxjerrjes jashtë përdorimit) të mbajtura për shitje maten me vlerën më të ulët midis vlerës kontabël dhe vlerës së drejtë, minus harxhimet e pritshme për shitje. Menjëherë përpara klasifikimit fillestar të mjetit (ose grupit të nxjerrjes jashtë përdorimit) si një mjet i mbajtur për shitje, vlera kontabël e mjetit matet në pajtim me kërkesat e pozicionit të duhur për mjetet afatgjata ku ato i përkisnin më parë. Banka Popullore nuk llogarit zhvlerësimin e mjeteve afatgjata të mbajtura për shitje për sa kohë që mjeti është i klasifikuar në këtë pozicion ose përderisa është pjesë e grupit të nxjerrjes jashtë përdorimit.

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

LI Mjetet afatgjata të mbajtura për shitje dhe grupi i nxjerrjes jashtë përdorimit (vazhdon)

Humbja nga zhvlerësimi njihet në raportin e të ardhurave për çdo reduktim fillestar ose të mëvonshëm të vlerës së mjetit (ose grupit të nxjerrjes jashtë përdorimit) në vlerën e drejtë minus harxhimet e shitjes. Në rast të një rritjeje të mëvonshme në vlerën e drejtë, minus harxhimet e shitjes (humbje nga zhvlerësimi), fitimi njihet në raportin e të ardhurave deri në shumën e humbjeve kumulative nga zhvlerësimi të njohura më parë.

M Pasuri të paluajtshme dhe pajisje

Të gjithë artikujt e pasurisë së paluajtshme dhe pajisjeve njihen me harxhimet e tyre minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë.

Toka, monedhat numizmatike dhe zotërimet e bibliotekës njihen sipas vlerës së tyre të blerjes dhe nuk janë subjekt amortizimi.

Pikturat e artit njihen me vlerën e drejtë dhe nuk i nënshtrohen amortizimit. Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në të ardhurat e tjera përmbledhëse në rezervën e rivlerësimit për veprat e artit.

Investimet në progres tregohen me çmimin e blerjes të përgatitjes së tyre duke përfshirë harxhimet e palëve të treta. Gjatë investimit nuk llogaritet amortizimi. Pas përfundimit të performancës, të gjitha harxhimet e grumbulluara transferohen në pronën dhe pajisjet përkatëse dhe i nënshtrohen normës së duhur të amortizimit. Fitimet dhe humbjet nga shpenzimet e pasurive të paluajtshme dhe pajisjeve janë paraqitur në bilansin e të ardhurave.

Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën lineare, bazuar në jetëgjatësinë e dobishme të vlerësuar të pasurisë së paluajtshme dhe pajisjeve, siç tregohet më poshtë:

	2022	2021
Objekte ndërtimore	5 deri më 50 vite	5 deri më 50 vite

Pajisjet	2 deri më 10 vite	2 deri më 10 vite
Mjetet e transportit	5 deri më 6 vite	5 deri më 6 vite
Mobilje zyre	5 deri më 10 vite	5 deri më 10 vite

Jetëgjatësia pronës dhe pajisjeve rishikohet dhe rregullohet të paktën një herë në vit, ose nëse konsiderohet e nevojshme dhe zbatohet në mënyrë prospektive.

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

N Aktivet e patrupëzuara

Aktivët e patrupëzuara përbëhen nga programe kompjuterike dhe licenca. Aktivët paraqiten me harxhimet minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Ato amortizohen sipas metodës lineare për jetëgjatësinë e dobishme të vlerësuar, e cila është nga dy deri në pesë vjet.

Nj Qiratë (mjetet me të drejtë përdorimi (mjetet të marra me qira) dhe detyrimet për qira)

Mjetet e së drejtës së përdorimit - mjetet e marra me qira fillimisht njihen me vlerën e tyre të blerjes në datën e fillimit të vlefshmërisë së marrëveshjes së qirasë, e cila është e barabartë me vlerën fillestare të detyrimeve të qirasë, e rritur nga pagesat e qirasë të bëra përpara ose në datën e fillimit të vlefshmërisë së marrëveshjes së qirasë dhe çdo harxhim që varet drejtpërdrejt nga marrëveshja e qirasë. Më pas, mjetet me të drejtë të përdorimit maten me vlerën kontabël fillestare minus deprecizimin / amortizimin dhe zhvlerësimin e akumuluar dhe rregullohen për rregullime tëaktuara të detyrimit të qirasë.

Detyrimet e qirasë fillimisht njihen me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të qirasë, të skontuara duke përdorur normën e qirasë kontraktuale. Nëse nuk është e specifikuar në kontratë, përdoret një normë rritëse, e cila përcaktohet në bazë të normës vjetore të interesit që mbizotëron në tregun e letrave me vlerë afatgjatë të emetuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut, me maturim të barabartë ose më të afërt me periudhën e marrë me qira. Më pas, detyrimi i qirasë rritet për shpenzimet e interesit të qirasë, zvogëlohet për pagesat e qirasë të bëra dhe rregullohet kur shuma që do të paguhej rivlerësohet ose kur pagesat e ardhshme të qirasë ndryshojnë.

Për mjetet me të drejtë përdorimi (mjetet e marra me qira), deprecizimi / amortizimi llogaritet duke përdorur metodën lineare, bazuar në kohëzgjatjen kontraktuale të përdorimit të mjetit të marrë me qira, me efektet e njohura në raportin e të ardhurave. Efektet e shpenzimeve të interesit mbi detyrimin e qirasë njihen në raportin e të ardhurave dhe shpenzimeve, me shpenzime të shpërndara përgjatë gjithë afatit të qirasë.

Për mjetet e marra me qira, me afat përdorimi 12 muaj ose më pak dhe për qiratë me vlerë të ulët, pagesat e qirasë njihen si shpenzim operativ në raportin e të ardhurave për kohëzgjatjen e qirasë.

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

O Humbjet për shkak të zhvlerësimit të mjeteve jofinanciare

Mjetet që kanë jetë të pakufizuar nuk i nënshtrohen zhvlerësimit dhe amortizimit dhe testohen për dëmtime në baza vjetore. Mjetet që i nënshtrohen zhvlerësimit dhe amortizimit rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka dëshmi objektive të zhvlerësimit (të dëmtuara fizikisht, të vjetruara, të vjedhura, të humbura ose ngjarje të tjera që reduktojnë vlerën në përdorim të mjetit). Nëse ekziston një evidencë e tillë, vlerësohet vlera e rikuperueshme e mjeteve. Një humbje nga rënia në vlerë është e barabartë me shumën me të cilën vlera kontabël e mjetit tejkalon shumën e rikuperueshme të tij. Shuma e rikuperueshme është më e madhja midis vlerës së drejtë të mjetet minus harxhimet e shitjes dhe vlerës në përdorim të mjetit. Gjatë vlerësimit të zhvlerësimit të mjeteve, ato grupohen nga niveli më i ulët sipas aftësisë për të gjeneruar flukse monetare (njësi gjeneruese të rrjedhës së parasë). Të gjitha mjetet jofinanciare, përveç vullnetit të mirë, për të cilat është njohur një humbje nga zhvlerësimi, i nënshtrohen analizës për të përcaktuar nëse ka një mundësi të anulimit të humbjes nga zhvlerësimi në datën e raportimit.

P Monedha nga metale të çmuara

Monedhat e metaleve të çmuara përfshijnë monedhat përkujtimore dhe monedhat koleksioniste.

Monedhat përkujtimore nuk janë mjet pagesor dhe zakonisht përmbajnë vlerë artistike ose kolektive dhe për rrjedhojë, shiten me çmim më të lartë se vlera e metalit nga i cili janë përpunuar. Banka Popullore prodhon monedha përkujtimore për të përkujtuar ngjarje të rëndësishme, bazuar në vendimin e Qeverisë. Monedhat përkujtimore vlerësohen me çmimin e tyre të shitjes, të miratuar nga Këshilli i Bankës Popullore.

Monedhat për qëllime koleksioni janë mjete ligjore në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe zakonisht përmbajnë vlerë artistike dhe koleksioniste. Monedhat për qëllime koleksioni maten fillimisht me vlerën më të ulët të harxhimeve të tyre dhe vlerës neto të realizueshme.

Të hyrat nga shitja e monedhave të metaleve të çmuara njihen nëse ka mundësi që Banka Popullore të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen prej tyre dhe nëse ky përfitim mund të matet me besueshmëri.

Q Kartëmonedha dhe monedha në qarkullim

Kartëmonedhat dhe monedhat në qarkullim të emetuara nga Banka Popullore paraqiten në Raportin e Pozicionit Financiar si detyrim në favor të mbajtësit, të shprehur në vlerë nominale. Kur kartëmonedhat dhe monedhat tërhiqen nga qarkullimi, detyrimi për paratë e depozituara rritet dhe detyrimi në favor të mbajtësit për paratë e gatshme zvogëlohet.

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

R Letrat me vlerë afatshkurtër

Letrat me vlerë afatshkurtër (bonot e thesarit) emetohen ekskluzivisht në monedhën vendase me një periudhë maturimi 28/35 ditë. Letrat me vlerë afatshkurtër (bono thesari), të emetuara

nga Banka Popullore për arritjen e objektivave të politikës monetare, regjistrohen sipas vlerës së skontuar, duke pasqyruar shumat e paguara nga bankat dhe kursimoret për marrjen e tyre. Interesi llogaritet dhe regjistrohet sipas maturimit. Bonot e thesarit të Bankës Popullore fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me blerjen e amortizuar.

Nj Depozitat

Depozitat pranohen fillimisht sipas vlerës së tyre objektive. Depozitat maten rrjedhimisht sipas vlerës së tyre blerëse. Në depozita përfshihen: depozitat e bankave dhe kursimoreve, depozitat e disponueshme të bankave dhe kursimoreve, rezerva e detyrueshme e bankave në valutë të huaj dhe rezerva e detyrueshme e kursimoreve në denarë, depozita tjera të bankave dhe kursimoreve, depozitat e shtetit, depozitat e kufizuara dhe depozitat tjera.

O Rezerva të veçanta

Rezervat e veçanta pranohen kur Banka Popullore ka detyrim aktual ligjor ose konstruktiv, i cila është krijuar si rezultat i ngjarjeve të kaluara edhe për të cilin me shumë mundësi do të ndodhë dalje e mjeteve për të shlyer atë detyrim dhe ekziston mundësia për vlerësimin e detyrimit.

P Kreditë

Kredia njihet kur të ndodh, sipas vlerës objektive neto nga kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestar, kreditë me interes maten sipas vlerës së tyre blerëse. Nëse borxhi shlyhet para maturimit të tij, çdo diferencë mes shumës së paguar dhe vlerës kontabiliste shfaqet në pasqyrën e të ardhurave.

Q Njohja të hyrave dhe shpenzimeve

Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi

Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi janë të shfaqura në pasqyrat e të ardhurave për të gjithë instrumentet e interesit, me përjashtim të interesit nga letrat me vlerë, të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave, në bazë llogaritëse, me përdorimin e metodës së normës efektive të interesit.

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

Q Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve (vazhdon)

Të hyrat nga dividendët

Dividentët të cilët dalin nga investimet pronësore të klasifikuara si mjete financiare të matura sipas vlerës objektive përmes fitimit të mbetur gjithëpërfshirës në pasqyrën e të ardhurave kur të përcaktohet e drejta për pranim të pagesës.

Provizione dhe të ardhura dhe shpenzime tjera

Të ardhurat nga provizionet dhe tarifat dhe llojet tjera të të ardhurave njihen me bazë llogaritëse.

Shpenzimet nga provizionet dhe tarifat dhe llojet tjera të shpenzimeve njihen me bazë llogaritëse.

Të ardhurat neto nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave dhe instrumenteve financiare të derivateve

Të ardhurat neto nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave i përfshijnë interesat e përlogaritura nga letrat me vlerë të kuponit, fitimet dhe humbjet e realizuara si rezultat i shitjes dhe ndryshimeve negative dhe pozitive të parealizuara në vlerën objektive të letrave me vlerë përmes vlerës objektive nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave (sipas parimit "letër pas letre"). Fitimet dhe humbjet nga ndryshimi i vlerës objektive të transaksioneve me instrumente financiare të derivateve njihen në pasqyrën e të ardhurave.

R Ndryshimet e parealizuara të kursit të këmbimit dhe të çmimeve

Ndryshimet e parealizuara të kursit të këmbimit dhe çmimeve janë rezultat i përshtatjes së vlerës së mjeteve dhe detyrimeve të denominuara në valutë të huaj me vlerën e kursit të denarit dhe ndryshimet në çmimin e tregut në ditën e raportimit.

Rr Përfitimet e punonjësve

Kontribut për sigurimin pensional - plan për kontribute të definuara

Detyrime për kontributet e definuara për sigurim pensional në sistemin pensional të Republikës së Maqedonisë së Veriut njihen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave për periudhën kur ndodh detyrimi.

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabiliste (vazhdon)

Rr Përfitimet e punonjësve (vazhdon)

Përfitime tjera afatgjata për punonjësit

Përfitimet tjera afatgjata për punonjësit përfshijnë pagesat e daljes në pension dhe e drejta e dhuratave jubilarë të punonjësve të cilët kanë punuar te punëdhënësi 10, 20, 30 ose 40 vite. Këto përfitime janë në pajtim me Ligjin për marrëdhëniet e punës dhe me Marrëveshjen kolektive të Bankës Popullore.

Detyrimi për përfitime afatgjata për punonjësit, përveç kontributeve të sigurimit pensional, është i njejtë me shumën e përfitimeve të ardhshme të cilat i realizojnë punonjësit në bazë të mundit të tyre në periudhat aktuale dhe të kaluara, i zbritur deri në vlerën aktuale duke aplikuar normë interesi të ponderuar për obligacionet afatgjata të emetuara nga qeveria në vitin financiar aktual.

S Tatimet

Në pajtim me rregulloret në fuqi për tatimin mbi fitim, Banka Popullore është e liruar nga tatimi mbi fitim.

Në pajtim me rregulloret në fuqi për tatimin mbi fitim, Banka Popullore është e liruar nga tatimi mbi pronë.

Banka Popullore është e obliguar të llogarisë tatimin e mbajtur për shërbimet e marra nga persona juridik të huaj në pajtim me ndryshimet e Ligjit për tatim mbi fitim nga viti 2014, i cili zbatohet nga 1 janari i vitit 2015.

Sh Raportim sipas segmenteve

Aktivitetet e Bankës Popullore formojnë një segment operativ dhe realizohen në një zonë gjeografike, Republika e Maqedonisë së Veriut. Banka Popullore ka shumë të konsiderueshme të mjeteve financiare dhe detyrimeve financiare si pjesë e aktiviteteve të udhëheqjes me rezervat valutore dhe operacionet e tregut vendas. Këto aktivitete nuk formojnë segmente të veçanta operative.

3. Menaxhimi me rrezikun financiar

Raporti i gjendjes financiare të Bankës Popullore përbëhet nga instrumentet financiare. Këto instrumente e ekspozojnë Bankën Popullore ndaj rreziqeve financiare, përfshirë edhe rrezikun kreditor, rrezikun e tregut (rreziku nga dallimet e kursit dhe rreziku i normave të interesit) dhe rrezikut të likuiditetit.

A Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rrezik nga mos shlyerja e detyrimeve nga pala e kontraktuar, ulja e vlerës së fondeve si rezultat i uljes së rejtingut kreditor të institucionit financiar të kontraktuar ose bankës komerciale ku ruhen rezervat valutore dhe mjetet tjera financiare, ose të emetuesit të instrumentit në të cilin vendosen rezervat valutore, si dhe rreziku i rritjes së diferencës së rendimenteve mes letrave me vlerë të shtetit më të sigurta dhe instrumentet tjera.

Mjetet valutore vendosen në instrumente të emetuara ose garantuara nga shtete ose subjekte shtetërore, qeveri rajonale ose lokale, institucione financiare ndërkombëtare dhe banka multilaterale të zhvillimit, banka afariste dhe institucione financiare, me rejting kreditor afatgjatë prej së paku BBB-/Baa3 ose të përshtatshëm, të caktuar nga agjencitë për rejting kreditor të njohura ndërkombëtarisht ("Standard & Poor's", "Moody's" dhe/ose "Fitch"). Nëse vlerësimet për rejting kreditor dallojnë, përdoret rejting kompozitar (rejting i ponderuar mesatar).

Banka Popullore udhëheq me rejtingun kreditor nëpërmjet diversifikimit të investimeve. Lidhur me këtë, janë përcaktuar limite kuantitative për investimet sipas vendeve individuale dhe institucioneve financiare. Përkrah kësaj, caktohet edhe shuma maksimale e mjeteve të vendosura në lloje të letrave me vlerë⁶ edhe në emisionet individuale të letrave me vlerë.

Monitorimi i ekspozimit të mjeteve valutore të rrezikut kreditor kryhet në bazë ditore.

Palët kontraktuese të Bankës Popullore janë të ndara në bazë të shkallës së rejtingut, e cila është e shprehur më tej. Qëllimi i shkallës së rejtingut është ti klasifikojë palët kontraktuese dhe emetuesit e letrave me vlerë të borxhit (obligimet, letra tregtare, letra të skontos dhe certifikata për depozita) sipas aftësisë kreditore. Aftësia kreditore e palëve kontraktuese dhe emetuesëve të obligimeve bazohet në rejting afatgjatë të përcaktuar nga agjencitë e rejtingut kreditor. Rejtingjet kreditore afatgjata të bankave të huaja janë vlerësime dhe mendime për aftësinë e bankës për shlyerje të shpejtë të detyrimeve depozitare në valutë të huaj dhe/ose vendase. Rejtingjet kreditore të emetuesëve janë vlerësime dhe mendime për aftësinë e emetuesëve për plotësimin e detyrimeve dhe marrëveshjeve financiare.

⁶ Për instrumentet më të sigurta përcaktohet një shumë minimale e lejuar.

3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)**A Rreziku kreditor (vazhdon)**

Banka Popullore përcakton një shumë të humbjes së pritur kreditore në bazë të probabilitetit të vlerësuar, si dallim mes rrjedhave monetare të cilat ndodhin sipas kushteve të marrëveshjes së instrumentit financiar dhe të rrjedhave monetare të cilat Banka Popullore pritët ti shlyej. Banka Popullore përcakton një shumë të humbjes së pritur kreditore të fondeve të cilat maten sipas vlerës së amortizuar blerëse.

Humbja e pritur kreditore matet sipas rrezikut për mospagesë, varësisht nga niveli i rrezikut kreditor dhe nëse rreziku kreditor i emetuesit/palës së kontraktuar konsiderueshëm është rritur nga njohja fillestare e ekspozimit. Rregullimi i vlerës për ekspozimet me rejting investues kreditor dhe për të cilat rreziku i kredisë nuk është rritur ndjeshëm (niveli 1) bazohet në humbjen e pritshme të kredisë për 12 muaj. Rregullimi i vlerës për ato ekspozime që kanë pësuar rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor (niveli 2 dhe niveli 3) është në bazë të humbjes së pritur kreditore për tërë jetëgjatësinë e instrumentit. Rritje e konsiderueshme e rrezikut kreditor llogaritet nëse instrumenti, emetuesi ose pala e kontraktuar migrojnë nga rejtingu kreditor investues, në joinvestues. Instrumentet financiare rrjedhat monetare të të cilave vonohen prej 30 deri 90 ditë gjithashtu migrojnë në nivelin 2 dhe 3, varësisht nga vonesa, vetëm nëse vonesa nuk është në bazë të arsyeve operative.

Llogaritja e humbjes së pritur kreditore bëhet në bazë të ekspozimit ndaj emetuesit/palës kontraktuese, humbjes së vlerësuar në rast të mospërbushjes së detyrimit të kontraktuar dhe probabilitetit të mospërbushjes në një periudhë të caktuar kohore, të përshtatur për skenaret e pritura makroekonomike. Njëkohësisht, përqindja e humbjes kushtëzohet nga prioriteti i kërkesës (prioritare ose subordinare) dhe probabiliteti i mospërbushjes vjen nga të dhënat historike për ndryshim të rejtingjeve kreditore, të cilat i publikojnë agjenci të njohura ndërkombëtare të rejtingut kreditor. Përshtatjet aplikohen në probabilitetin e mospërbushjes në bazë të regresit linear të treguesit për stabilitet të sistemit financiar, të matur nëpërmjet shkallës së kredive me probleme bankare, si koeficient i përshtatjes ekonomike të më shumë treguesëve makroekonomik.

Banka Popullore, në kuadër të udhëheqjes me rrezikun kreditor në bazë mujore përcakton edhe vlerë të ekspozuar me rrezikun kreditor të rezervave valutore, e cila përfshin përllogaritje të humbjes kreditore të pritur dhe të papritur (të llogaritur sipas udhëzimeve të Bazel 3 për llogaritje të kapitalit ekonomik, pra kapitalit për të mbuluar humbjen e papritur) për të gjitha instrumentet në kuadër të rezervave valutore.

Shkalla krahasuese e rejtingut	Rejting kreditor afatgjatë
Vlerësim investues	AAA, AA+, AA, AA-, A+, A, A-, BBB+, BBB, BBB-
Vlerësim joinvestues	BB+, BB, BB-, B+, B, B-, ose më të ulët

3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)**A Rreziku kreditor (vazhdon)**

Vëllimi dhe ekspozimi i Bankës Popullore ndaj rrezikut kreditor paraqitet në Raportin për gjendjen financiare dhe në shënimet për Raportin për gjendjen financiare të cilat i përshkruajnë mjetet financiare. Ekspozimi në bazë të rejtingut kreditor paraqitet sipas rejtingut mesatar kreditor të mjeteve financiare, të marrë nga vlerësimet e dhëna nga agjencitë e njohura ndërkombëtare për rejting kreditor "Standard & Poor's", "Moody's" dhe/ose "Fitch". Kjo mënyrë e paraqitjes është e përshtatshme me qasjen në përcaktimin dhe monitorimin e ekspozimit të rrezikut kreditor gjatë udhëheqjes me rezervat valutore dhe është i përshkruar me Rregullat e udhëheqjes dhe investimit të rezervave valutore, të miratuara nga guvernatori.

Tabela në vijim e paraqet strukturën e mjeteve financiare:

MJETE	2022	2021
Depozita në valutë të huaj	53.654.174	41.819.630
- Depozita valutore pa afat	44.224.516	41.819.630
- Depozita valutore me afat në banka të huaja	9.429.658	-
Letra me vlerë të huaja	157.847.953	157.372.715
Depozita të arit	23.113.182	21.883.881
Të drejta të veçanta të tërheqjes	24.679	80.443
Kërkesa në bazë të transaksioneve repo devizore	8.902.551	2.127.117
Kërkesa nga shteti për marrëdhëniet me FNM-në	32.643.436	25.948.414
Kërkesat nga puna dhe mjetet tjera	140.663	77.004
Më 31 dhjetor	276.326.638	249.309.204

Analiza e strukturës së instrumenteve financiare në Bankën Popullore tregon pjesëmarrje të moderuar të mjeteve të vendosura në depozitat valutore me afat në banka të huaja, të cilat mungonin në vitin 2021. Domethënë, normat pozitive të interesit në gjysmën e dytë të vitit 2022 e kanë rritur atraktivitetin e këtyre instrumenteve. Transaksionet repo u bënë në një vëllim më të madh krahasuar me vitin e kaluar, shkaku i mundësisë të realizimit të të ardhurave shtesë, në kushte të interesit të rritur të pjesëmarrësve të tregut për huazimin e letrave me vlerë me cilësi të lartë nëpërmjet transaksioneve repo. Gjithashtu, shënohet një shumë më e lartë e depozitave valutore pa afat në llogaritë rrjedhëse te bankat qendrore të vendeve anëtare të eurozonës, në kushte të pasigurisë për kërkesën e valutave në tregun valutor vendas, por edhe shkaku i pritjeve për rritje të rendimenteve në periudhën e ardhshme dhe rrjedhimisht, vendosjen e mjeteve sipas rendimenteve më të larta.

Në tabelat në vijim shfaqet një pasqyrë e mjeteve financiare me gjendje të 31 dhjetor 2022, pra 31 dhjetor 2021, të cilat nuk janë maturuar dhe janë korigjuar për zhvlerësim të humbjes së prititur kreditor (për instrumentet e matura sipas vlerës së amortizuar blerëse), të analizuar sipas rejtingut kreditor mesatar të mjeteve financiare, të marrë nga vlerësimet e dhëna nga agjencitë e njohura ndërkombëtare për rejting kreditor "Standard & Poor's", "Moody's" dhe/ose "Fitch".

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(Të gjitha shumatat janë të shprehura në mijë MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)****A Rreziku kreditor (vazhdon)**

Mjetet financiare të korigjuara individualisht për zhvlerësim më 31 dhjetor 2022, pra 31 dhjetor 2021, shfaqen në kategoritë "Depozita valutore me afat në banka të huaja" (shënimi 16), "Letra me vlerë të huaja" (shënimi 17), "Kërkesa në bazë të transaksioneve repo valutore" (shënimi 21), "Kërkesa tjera" (shënimi 25) dhe "Kërkesa nga puna" (shënimi 29). Zhvlerësimi i humbjes së pritur kreditorë për investimet në instrumente financiare lëviz në kornizat e nivelit 1, ku nuk ka lëvizje prej njërit në tjetrin nivel të ekspozimit të rrezikut. Kërkesat nga puna i përmbajnë edhe kërkesat për të cilat është realizuar zhvlerësim i plotë dhe janë klasifikuar në nivelin 3, me shumë totale prej 156.068 MKD.

Rejting 31dhjetor 2022	Depozita valutore pa afat	Depozita valutore me afat në banka të huaja	Letra të vlerës të huaja	Depozita të arit	Të drejta të veçant a të tërheqjes	Kërkesa në bazë të transaksioneve repo valutore	Kërkesa nga shteti për marrëdhëni me FNM-në	Kërkesa nga puna dhe mjetet tjera	Gjithsej
AAA	18.700.891	-	37.481.054	-	-	-	-	-	56.181.945
AA+	7.389.572	-	35.651.860	-	-	-	-	-	43.041.432
AA	1.850.992	-	26.416.696	4.182.188	-	-	-	-	32.449.876
AA-	11.601	-	16.294.976	18.913.167	-	-	-	-	35.219.744
A+	4.426.934	-	6.454.913	-	-	-	-	-	10.881.847
A	44.816	9.429.658	4039385	-	-	8.902.551	-	-	22.416.410
A-	7.847	-	11.381.982	-	-	-	-	-	11.389.829
IFN ⁷	32.989	-	3.634.707	17.827	24679	-	-	-	3.710.202
BBB-	-	-	2.190.484	-	-	-	-	-	2.190.484
BBB	11.758.874	-	13.683.951	-	-	-	-	-	25.442.825
BBB-	-	-	617.945	-	-	-	-	-	617.945
BB ⁸	-	-	-	-	-	-	32.643.436	-	32.643.436
Të paranguara ⁹	-	-	-	-	-	-	-	140.663	140663
Gjithsej	44.224.516	9.429.658	157.847.953	23.113.182	24.679	8.902.551	32.643.436	140.663	276.326.638

⁷ Institucione financiare ndërkombëtare⁸ Rejtingu i Republikës së Maqedonisë së Veriut⁹ Klientë në vende ku nuk kanë rejting kreditor sipas agjencive të njohura ndërkombëtare për rejting kreditor "Standard & Poor's", "Moody's" dhe/ose "Fitch".

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(Të gjitha shumatat janë të shprehura në mijë MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)****A Rreziku kreditor (vazhdon)**

Rejting 31 2021	Depozita dhjetor valutore pa afat	Letra të vlerës pa të huaja	Depozita të arit	Të drejta të veçanta të tërheqje s	Kërkesa në bazë të transaksio neve repo valutore	Kërkesa nga shteti për marrëdhëni et me FNM- në	Kërkesat nga puna dhe mjetet tjera	Gjithsej
AAA	77	29.878.258	-	-	-	-	-	49.649.114
AA+	7.882.698	36.473.059	-	-	-	-	-	44.355.757
AA	1.231.835	21.655.783	-	-	-	-	-	22.887.618
AA-	623.354	10.931.036	21.866.997	-	-	-	-	33.421.387
A+	4.868.945	11.345.844	-	-	-	-	-	16.214.789
A	12.750	2.966.850	-	-	2.127.117	-	-	5.106.717
A-	8.692	18.901.025	-	-	-	-	-	18.909.717
IFN ¹⁰	2.799	4.561.135	16.884	80.443	-	-	-	4.661.261
BBB	7.417.701	20.330.054	-	-	-	-	-	27.747.755
BBB-	-	329.671	-	-	-	-	-	329.671
BB ¹¹	-	-	-	-	-	25.948.414	-	25.948.414
Të paranguara ¹²	-	-	-	-	-	-	77.004	77.004
Gjithsej	41.819.630	157.372.715	21.883.881	80.443	2.127.117	25.948.414	77.004	249.309.204

¹⁰ Institucione financiare ndërkombëtare¹¹ Rejtingu i Republikës së Maqedonisë së Veriut¹² Klientë në vende ku nuk kanë rejting kreditor sipas agjencive të njohura ndërkombëtare për rejting kreditor "Standard & Poor's", "Moody's" dhe/ose "Fitch".

3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)**A Rreziku kreditor (vazhdon)****Koncentrim të rreziqeve të mjeteve financiare me ekspozim të rrezikut kreditor**

Tabela që vijon shfaq ekspozimin kreditor të mjeteve të Bankës Popullore sipas vlerës kontabël, të klasifikuar sipas rajoneve gjeografike më 31 dhejtor 2022. Për nevojat e kësaj tabele, Banka Popullore klasifikon ekspozimin e rajoneve sipas vendit nga ku vijnë palët kontraktuese:

	Vende anëtare të BE-së	Vende europiane që nuk janë pjesë e BE-së	Republika e Maqedonisë së Veriut	Vende tjera anëtare të OECD ¹³	Vende tjera	Gjithsej
Depozita valutore pa afat	37.774.125	34.678	-	6.415.639	74	44.224.516
Depozita valutore me afat në banka të huaja	9.429.658	-	-	-	-	9.429.658
Letra të vlerës të huaja	125.804.299	2.709.823	-	24.546.876	4.786.955	157.847.953
Depozita të arit	4.182.188	18.930.994	-	-	-	23.113.182
Të drejta të veçanta të tërheqjes	-	-	-	24.679	-	24.679
Kërkesa në bazë të transaksioneve repo valutore	8.902.551	-	-	-	-	8.902.551
Kërkesat nga shteti për marrëdhënie me FNM	-	-	32.643.436	-	-	32.643.436
Kërkesat nga puna dhe mjetet tjera	-	-	140.663	-	-	140.663
31 dhjetor 2022	186.092.821	21.675.495	32.784.099	30.987.194	4.787.029	276.326.638
31 dhjetor 2021	164.159.069	23.366.843	26.025.418	24.993.064	10.764.810	249.309.204

¹³ Vende tjera anëtare të OECD të cilat nuk janë pjesë e BE-së ose vendeve europiane që nuk janë pjesë e BE-së.

3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)**B Rreziku tregut**

Banka Popullore ndjek dhe udhëheq edhe me rrezikun valutor dhe të interesit, si rreziqe themelore të tregut. Qëllimi bazë i Bankës Popullore gjatë udhëheqjes me rreziqet e tregut është sqaruar në shënimin nr. 1. Rreziku valutor paraqet rrezik nga ulja e vlerës së instrumenteve financiare në valutë të huaj shkaku ndryshimit të marrëdhënieve intervaltore të valutave. Rreziku interesit paraqet rrezik nga ulja e vlerës së tregut të instrumenteve financiare shkaku lëvizjeve të pafavorshme të normave të interesit. Udhëheqja me rrezikun e tregut bëhet me përcaktim të kohëzgjatjes së përshtatur për portofolet të cilat monitorohen në bazë ditore. Gjithashtu, rreziku tregut kontrollohet edhe përmes përcaktimit të buxhetit për rrezik, me të cilin definohet niveli i pranueshëm i rrezikut të tregut të rezervave valutore.

Që të matë efektin e rreziqeve të tregut mbi vlerën e rezervave valutore, Banka Popullore zbaton konceptin e “vlerës së ekspozuar në rrezik” – VAR (ang. Value at Risk ose VAR). VAR paraqet metodologji statistike e cila e vlerëson ndryshimin maksimal të vlerës së rezervave valutore për shkak të ndryshimit të çmimeve të instrumenteve financiare dhe ndryshimi i kursit të këmbimit dhe me një nivel të caktuar të besueshmërisë për një periudhë të caktuar kohore. Banka Popullore, gjatë llogaritjes së VAR-it, e përdor nivelin e besueshmërisë nga 95% për periudhë kohore një vjeçare¹⁴ dhe 99% për një interval kohor prej dhjetë ditëve¹⁵.

Në dhjetor të vitit 2022, ekspozimi i rezervave valutore me të cilat udhëheq Banka Popullore (vlera e ekspozuar e rrezikut me nivel të besueshmërisë prej 99% për interval kohor prej dhjetë ditëve), për sa i përket luhatjeve të çmimeve të instrumenteve dhe kursit të këmbimit ndaj euros shënon 1.848.498 MKD (30.060.199 euro), ose 0,78% nga rezervat valutore. Në të njejtën kohe, VAR nga ndryshimi i kursit të këmbimit për të njejtën periudhë (në bazë të diversifikuar, me ndryshim të përfshirë të çmimit të arit) shënon 1.564.485 MKD (25.441.585 euro), ndërsa VAR nga ndryshimet e çmimeve të instrumenteve në të cilat janë investuar rezervat valutore shënon 284.013 mijë MKD (4.618.614 euro).

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Rrezik valutor	1.564.485	1.109.891
Rrezik interesi	284.013	27.159
Gjithsej VAR	1.848.498	1.137.050

¹⁴ Për vlerësim intern të buxhetit të vendosur për rrezik.

¹⁵ Lidhur me rekomandimet nga marrëveshja e Bazelit nga vitit 1999.

3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)

C Rreziku nga dallimet e kursit

Rreziku nga dallimet e kursit paraqet rrezik nga rënia e vlerës së mjeteve dhe detyrimeve financiare si rezultat i luhatjeve të kursit të këmbimit të valutave dhe çmimit të arit monetar.

Struktura valutore e rezervave valutore është e kushtëzuar nga struktura valutore e intervenimeve të mbështetjes së kursit të denarit ndaj euros, strukturës valutore të detyrimeve të Bankës Popullore dhe të shtetit ndaj vendeve të huaja, të shkëmbimit të jashtëm tregtar dhe nga nevojat tjera likuide. Rrjedhimisht, euro është më e përfaqësuar në strukturën valutore të rezervave valutore. Ekspozimi i rrezikut valutor aktiv (që vjen nga devijimi nga struktura bazë valutore) është kufizuar me nivelin e rezervave të rivlersimit nga diferencat e kursit. Duke e pasur parasysh "de fakto" kursin fiks valutor të denarit ndaj euros, ekspozimi ndaj rrezikut valutor të Bankës Popullore ndaj euros është minimal, për dallim nga valutat tjera, ku ekspozimi është i pranishëm shkaku luhatjes së tyre ndaj euros, me atë edhe ndaj denarit.

Në tabelat më poshtë janë të kyçura mjetet dhe detyrimet financiare të Bankës Popullore sipas vlerës së tyre aktuale me gjendje të 31 dhjetorit 2022, pra 31 dhjetor 2021, të analizuara sipas valutave.

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)****C Rreziku nga dallimet e kursit (vazhdon)**

Gjendja më 31 dhjetor 2022:

MJETE	EUR	USD	SPV	Valuta tjera	MKD	Gjithsej
Para të huaja të gatshme	2.397.435	543.022	-	23.790	-	2.964.247
Depozita në valutë të huaj	47.193.837	1.952.128	-	4.508.209	-	53.654.174
Letra të vlerës të huaja	157.691.806	114.939	41.208	-	-	157.847.953
Ari	-	23.155.343	-	-	-	23.155.343
Të drejta të veçanta të tërheqjes	-	-	24.679	-	-	24.679
Kërkesa në bazë të transaksioneve repo valutore	8.902.551	-	-	-	-	8.902.551
Kërkesa nga shteti për marrëdhëniet me FNM-në	-	-	32.643.436	-	-	32.643.436
Anëtarësim në FNM	-	-	11.070.941	-	-	11.070.941
Kërkesat nga puna dhe mjetet tjera	23.738	4	70.419	12.490	34.012	140.663
Gjithsej mjete	216.209.367	25.765.436	43.850.683	4.544.489	34.012	290.403.987
DETYRIME						
Para të gatshme në qarkullim	-	-	-	-	53.852.538	53.852.538
Depozita të bankave dhe kursimoreve	6.464.468	-	-	-	67.830.797	74.295.265
Rezerva të detyrueshme të bankave në valutë të huaj dhe rezervë e detyrueshme e kursimoreve në dërnarë	27.125.601	-	-	-	23.366	27.148.967
Bono të thesarit të Bankës Popullore	-	-	-	-	9.450.579	9.450.579
Detyrime në bazë të repo transaksioneve valutore	22.915.335	-	-	4.440.273	-	27.355.608
Depozitet e shtetit	16.343.803	12.845	-	4.055	23.983.580	40.344.283
Depozite të kufizuara	77.239	64.872	-	-	-	142.111
Detyrime ndaj FNM-së	-	-	43.714.377	-	-	43.714.377
Depozite tjera	-	-	-	-	2.762.513	2.762.513
Detyrime tjera	222.940	17.256	70.419	31.561	211.626	553.802
Gjithsej detyrime	73.149.386	94.973	43.784.796	4.475.889	158.114.999	279.620.043
Gjendja financiare neto	143.059.981	25.670.463	65.887	68.600	(158.080.987)	10.783.944

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(Të gjitha shumatat janë të shprehura në mijë MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)****C Rreziku nga dallimet e kursit (vazhdon)**

Gjendja më 31 dhjetor 2021:

MJETE	EUR	USD	SPV	Valuta tjera	MKD	Gjithsej
Para të huaja të gatshme	2.630.183	716.268	-	26.208	-	3.372.659
Depozita në valutë të huaj	34.994.732	1.930.338	837	4.893.723	-	41.819.630
Letra të vlerës të huaja	157.223.025	108.745	40.945	-	-	157.372.715
Ari	-	21.923.813	-	-	-	21.923.813
Të drejta të veçanta të tërheqjes	-	-	80.443	-	-	80.443
Kërkesa në bazë të transaksioneve repo valutore	2.127.117	-	-	-	-	2.127.117
Kërkesa nga shteti për marrëdhëniet me FNM-në	-	-	25.948.414	-	-	25.948.414
Anëtarësim në FNM	-	-	10.234.301	-	-	10.234.301
Kërkesat nga puna dhe mjetet tjera	412	2	764	11.894	63.932	77.004
Gjithsej mjete	196.975.469	24.679.166	36.305.704	4.931.825	63.932	262.956.096
DETYRIME						
Para të gatshme në qarkullim	-	-	-	-	51.392.438	51.392.438
Depozite të bankave	7.355.762	-	-	-	66.704.992	74.060.754
Rezerva të detyrueshme të bankave në valutë të huaj dhe rezerva e detyrueshme në kursimoret në denarë	19.940.411	-	-	-	20.251	19.960.662
Bonot e thesarit të Bankës Popullore	-	-	-	-	9.993.065	9.993.065
Detyrime në bazë të repo transaksioneve valutore	3.509.581	-	-	4.854.090	-	8.363.671
Depozitet e shtetit	22.053.247	9.681	-	4.416	24.919.606	46.986.950
Depozite të kufizuara	68.441	69.488	-	-	-	137.929
Detyrime ndaj FNM-së	-	-	36.182.715	-	-	36.182.715
Depozite tjera	-	-	-	-	2.333.764	2.333.764
Detyrime tjera	226.289	19.033	1.395	33.457	268.682	548.856
Gjithsej detyrime	53.153.731	98.202	36.184.110	4.891.963	155.632.798	249.960.804
Gjendja financiare neto	143.821.738	24.580.964	121.594	39.862	(155.568.866)	12.995.292

3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)

Ç Rreziku i interesit

Banka Popullore është e ekspozuar në rrezik të interesit si rezultat i mospajtueshmërisë të strukturës së interesit të mjeteve dhe detyrimeve financiare.

Qëllimi bazë i Bankës Popullore, arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve i jep të drejtë diskrete gjatë udhëheqjes me politikën monetare që ti përcaktojë normat e interesit të instrumenteve monetare. Por, në anën tjetër, Banka Popullore është e ekspozuar në rrezik të interesit gjatë udhëheqjes me rrezervat valutore, vetëm për shkak të ndikimit të ndryshimeve të jashtme të tregjeve financiare.

Pozita e Bankës Popullore mbi ndjeshmërinë e ndryshimeve të normave të interesit, e bazuar mbi momentin e përcaktimit të përsëritur të normës së interesit më 31 dhjetor 2022, pra 31 dhjetor 2021, është e shfaqur në tabelat në vijim. Tabelat i përfshijnë instrumentet financiare të Bankës Popullore sipas vlerës së tyre aktuale, të karakterizuara sipas datës më të hershme nga data e rivlerësimit ose datës së maturimit.

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Raporti financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë MKD, përderisa nuk është përcaktuar ndryshe)***3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)****Ç Rreziku i interesit (vazhdon)**

Gjendja më 31 dhjetor 2022:

MJETE	Artikuj me interes					Gjithsej artikuj me interes	Artikuj pa interes	Gjithsej
	Deri 1 muaj ose norma variable	Prej 1 deri në 3 muaj	Prej 3 muaj deri në 1 vjet	Prej 1 deri në 5 vjet	Mbi 5 vjet			
Para të huaja të gatshme	-	-	-	-	-	-	2.964.247	2.964.247
Depozita në valutë të huaj	53.599.667	-	-	-	-	53.599.667	54.507	53.654.174
Letra të vlerës të huaja	-	514.206	95.329.729	39.252.455	-	135.096.390	22.751.563	157.847.953
Ari	-	-	9.417.270	-	-	9.417.270	13.738.073	23.155.343
Të drejta të veçanta të tërheqjes	24.679	-	-	-	-	24.679	-	24.679
Kërkesa në bazë të transaksioneve repo valutore	8.896.365	-	-	-	-	8.896.365	6.186	8.902.551
Kërkesa nga shteti për marrëdhëniet me FNM-në	-	-	-	-	-	-	32.643.436	32.643.436
Anëtarësim në FNM	-	-	-	-	-	-	11.070.941	11.070.941
Kërkesat nga puna dhe mjetet tjera	-	-	-	-	-	-	140.663	140.663
Gjithsej mjete	62.520.711	514.206	104.746.999	39.252.455	-	207.034.371	83.369.616	290.403.987
DETYRIME								
Para të gatshme në qarkullim	-	-	-	-	-	-	53.852.538	53.852.538
Depozite të bankave	49.529.919	122.986	-	-	-	49.652.905	24.642.360	74.295.265
Rezerva të detyrueshme të bankave në valutë të huaj dhe rezerva e detyrueshme në kursimoret në denarë	-	-	-	-	-	-	27.148.967	27.148.967
Bonot e thesarit të Bankës Popullore	9.429.453	-	-	-	-	9.429.453	21.126	9.450.579
Detyrime në bazë të repo transaksioneve valutore	22.905.942	4.443.008	-	-	-	27.348.950	6.658	27.355.608
Depozitet e shtetit	10.687.111	-	-	-	-	10.687.111	29.657.172	40.344.283
Depozite të kufizuara	-	-	-	-	-	-	142.111	142.111
Detyrime ndaj FNM-së	-	-	-	-	-	-	43.714.377	43.714.377
Depozite tjera	-	-	-	-	-	-	2.762.513	2.762.513
Detyrime tjera	-	-	-	-	-	-	553.802	553.802
Gjithsej detyrime	92.552.425	4.565.994	-	-	-	97.118.419	182.501.624	279.620.043
Gjithsej rrezik të interesit	(30.031.714)	(4.051.788)	104.746.999	39.252.455	-	109.915.952	(99.132.008)	10.783.944

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Raporti financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë MKD, përderisa nuk është përcaktuar ndryshe)***3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)****Ç Rreziku i interesit (vazhdon)**

Gjendja më 31 dhjetor 2021:

MJETE	Artikuj me interes					Gjithsej artikuj me interes	Artikuj pa interes	Gjithsej
	Deri 1 muaj ose norma variable	Prej 1 deri në 3 muaj	Prej 3 muaj deri në 1 vjet	Prej 1 deri në 5 vjet	Mbi 5 vjet			
Para të huaja të gatshme	-	-	-	-	-	-	3.372.659	3.372.659
Depozita në valutë të huaj	41.818.805	-	-	-	-	41.818.805	825	41.819.630
Letra të vlerës të huaja	185.231	-	112.400.638	27.520.722	-	140.106.591	17.266.124	157.372.715
Ari	-	5.937.975	5.950.539	-	-	11.888.514	10.035.299	21.923.813
Të drejta të veçanta të tërheqjes	80.443	-	-	-	-	80.443	-	80.443
Kërkesa në bazë të transaksioneve repo valutore	2.127.896	-	-	-	-	2.127.896	(779)	2.127.117
Kërkesa nga shteti për marrëdhëniet me FNM-në	-	-	-	-	-	-	25.948.414	25.948.414
Anëtarësim në FNM	-	-	-	-	-	-	10.234.301	10.234.301
Kërkesat nga puna dhe mjetet tjera	-	-	-	-	-	-	77.004	77.004
Gjithsej mjete	44.212.375	5.937.975	118.351.177	27.520.722	-	196.022.249	66.933.847	262.956.096
DETYRIME								
Para të gatshme në qarkullim	-	-	-	-	-	-	51.392.438	51.392.438
Depozita të bankave	43.422.960	-	-	-	-	43.422.960	30.637.794	74.060.754
Rezerva të detyrueshme të bankave në deviza dhe rezerva e detyrueshme në kursimoret në denarë	19.940.411	-	-	-	-	19.940.411	20.251	19.960.662
Bonot e thesarit të Bankës Popullore	9.987.520	-	-	-	-	9.987.520	5.545	9.993.065
Detyrime në bazë të repo transaksioneve valutore	2.127.896	6.238.551	-	-	-	8.366.447	(2.776)	8.363.671
Depozitet e shtetit	6.000.000	-	-	-	-	6.000.000	40.986.950	46.986.950
Depozite të kufizuara	-	-	-	-	-	-	137.929	137.929
Detyrime ndaj FNM-së	-	-	-	-	-	-	36.182.715	36.182.715
Depozite tjera	-	-	-	-	-	-	2.333.764	2.333.764
Detyrime tjera	-	-	-	-	-	-	548.856	548.856
Gjithsej detyrime	81.478.787	6.238.551	-	-	-	87.717.338	162.243.466	249.960.804
Gjithsej rrezik të interesit	(37.266.412)	(300.576)	118.351.177	27.520.722	-	108.304.911	(95.309.619)	12.995.292

3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)**D Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rrezik nga mungesa e mjeteve likuide për zhvillim të papenguar të funksioneve të Bankës Popullore. Qëllimi bazë i Bankës Popullore gjatë udhëheqjes me rrezikun e likuiditetit është shpjeguar në shënimin 1.

Ruajtja e likuiditetit sigurohet me vendosjen e mjeteve valutore në llogari rrjedhëse në vende të huaja, në depozita me afat të shkurtër dhe në letra me vlerë të borxhit për të cilat ekziston një treg sekundar i thellë dhe likuid. Banka Popullore udhëheq me rrezikun e likuiditetit me përcaktimin dhe ruajtjen e mjeteve likuide në nivele përkatëse për zbatimin e politikës monetare dhe valutore, kryerjen e pagesave të rregullta dhe të kohshme të borxhit dhe rrjedhave të jashtme dhe/ose të dalurave kapitale me komponentë valutor në llogari të shtetit, si dhe përmbushjen e nevojave transaksionare gjatë udhëheqjes me rezervat valutore. Në të njëjtën kohë, në pajtim me Politikën dhe Rregulloren për udhëheqje dhe investim të rezervave valutore, udhëheqja me rrezikun likuidues është e përshtatur me praksat më të mira globale. Rrjedhimisht, me qëllim që të optimizohet udhëheqja me rezervat valutore, në të njëjtën kohë duka i marrë parasysh detyrimet dhe qëllimet e ndryshme të rezervave valutore në periudha të ndryshme kohore, rezervat valutore janë të shpërndara në disa portofole, kapital operativ (portofol operativ), portofol likuidues dhe investues.

Mjetet bazë për qëllime rekreative përfshijnë ndërtesat dhe mjetet e tjera bazë në kuadër të atyre ndërtesave.

Si pjesë e reformave të sistemit të pagesave, në vitin 2001 Banka Popullore mori përsipër funksionin e furnizimit me para të gatshme nga ish Enti i Qarkullimit Pagesor (EQP), si dhe një pjesë të ndërtesave, pajisjeve dhe mobiljeve të EQP-së që lidhen me këtë funksion në dhjetë qytete në vend. Këto mjete bazë iu dhanë në posedim Bankës Popullore, por pronësia ende nuk është bartur për shkak të pasqyrës së ndarë të papërfunduar të EQP-së dhe rrjedhimisht, mjetet nuk janë regjistruar në librat afariste të Bankës Popullore.

Në vitin 2013, me vendim të Qeverisë, Bankës Popullore i është dhënë e drejta për shfrytëzim të përhershëm të tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për ndërtimin e objektit të ri afarist. Toka nuk është e regjistruar në librat e Bankës Popullore. Më 31 dhjetor 2022, gjendja e investimeve në rrjedh për ndërtimin e objektit të ri afarist është 1,055,246 mijë denarë (2021: 974.932 mijë denarë). Në vitin 2022, Banka Popullore kishte depozitim të investimeve në vazhdim në vlerë prej 80.314 mijë denarë (2021: 166.297 mijë denarë), lidhur me ndërtimin e objektit të ri afarist (shënimi 45b).

Në korrik të vitit 2022, kontrata për kryerjen e punëve ndërtimore ishte ndërprerë, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve të kontratës nga kontraktori, dhe Banka Popullore ndërmoi aktivitete për mbrojtjen e objektit në ndërtim. Në tremujorin e fundit të vitit 2022, ndaj ish-kontraktorit është hapur procedurë parafalimentimi, e cila është ende në vazhdim. Nga fillimi i vitit 2023 po bëhen përgatitjet për vazhdimin e aktiviteteve me ndërtimin e objektit të ri.

Në vitin 2022 dhe 2021, Banka Popullore nuk ka ngarkesa në pasuri të paluajtshme dhe pajisje.

Raporti financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë MKD, përderisa nuk është përcaktuar ndryshe)***27. Aktive të patrupëzuara**

	2022	2021
Gjendja më 1 janar		
Vlera blerëse	281.413	262.479
Investime në rrjedh	6.242	6.103
Amortizimi i akumuluar	(255.694)	(239.777)
Vlera e tanishme	31.961	28.805
- Rritje të mjeteve gjatë vitit		
- Vlera blerëse	16.482	18.291
Reduktimi i fondeve gjatë vitit		
- Vlera blerëse	(1.301)	(2.431)
- Amortizimi i akumuluar	1.301	2.431
Transfertat		
- Vlera blerëse	-	3.074
- Amortizimi i akumuluar	-	(3.015)
Amortizimi i vitit	(14.532)	(15.333)
Investime në rrjedh	(5.637)	139
Gjendja më 31 dhjetor	28.274	31.961
Gjendja më 31 dhjetor		
- Vlera blerëse	296.594	281.413
Investime në rrjedh	605	6.242
Amortizimi i akumuluar	(268.925)	(255.694)
Vlera e tanishme	28.274	31.961

28. Monedha nga metalet e çmuara

Më 31 dhjetor 2022, gjendja e monedhave nga metalet e çmuara përfshin 5,815 mijë denarë (2021: 5.703 mijë denarë).

Monedha nga metalet e çmuara përfshijnë monedha të përshtatshme, monedha për qëllime koleksionimi dhe komplet monedhash.

Monedha të përshtatshme janë monedhat e arit dhe argjendit në bazë të vendimit të Qeverisë janë prodhuar për të shënuar përvjetorë të rëndësishëm për vendin. Më 31 dhjetor 2022, Banka Popullore kishte gjithsej 173 monedha ari dhe 25 monedha argjendi (31 dhjetor 2021: 173 monedha ari dhe 26 monedha argjendi).

Në pajtim me Ligjin e Bankës Popullore, nga qershori 2014, Banka Popullore filloi me aktivitetin e shitjes së monedhave për qëllime koleksionimi, të cilat janë edhe mjete pagese. Në vitin 2016, Banka Popullore filloi me shitjen e monedhave për qëllime koleksionimi dhe nëpërmjet punës së komisionit. Më 31 dhjetor 2022, Banka Popullore kishte rezervë prej 218 copa monedha për qëllime koleksionimi (31 dhjetor 2021: 268 copa).

28. Monedha nga metalet e çmuara (vazhdon)

Më 31 dhjetor 2022, Banka Popullore kishte rezervë 2.856 copa komplet monedhash (në vitin 2021: 2.931 copa komplet monedhash).

Të hyrat nga shitja e monedhave për qëllime koleksionimi dhe nga shitja e komplet monedhash janë treguar në shënimin 11.

29. Kërkesat e punës

Kërkesat e punës përbëhen nga kërkesat në valutë të bazuara në interesin e paguar, provizionet dhe shpenzimet e tjera për llogarinë e shtetit në bazë të alokimit kumulativ neto (ANK) nga FMN-ja, kërkesat në bazë të tarifave dhe provizioneve për shërbimet e kryera nga Banka Popullore, kërkesat për mirëmbajtjen e Kompleksit të Bankës dhe kërkesa të tjera:

	2022	2021
Kërkesat në valutë të bazuara në interesin e paguar, provizionet dhe shpenzimet për llogarinë e shtetit (ANK)	70.419	765
Tarifa dhe provizione	38.041	30.515
Kërkesa për mirëmbajtjen e Kompleksit të Bankës	2.643	1.614
Kërkesa të tjera	564.844	407.814
Korrigjimi i vlerës së kërkesave të tjera	(564.844)	(407.814)
Gjithsej	111.103	32.894

Lëvizja e korrigjimit të vlerës së kërkesave të tjera është treguar në vazhdim:

	2022	2021
Gjendja më 1 janar	407.814	406.961
Rritja e korrigjimit të kërkesave në bazë të dënimit kontraktues (shënimi 14)	147.733	-
Rritja e korrigjimit të vlerës për kërkesat e interesit (shënimi 14)	7.420	1
Rritja e korrigjimit të vlerës për kërkesat nga tarifat dhe provizionet (shënimi 14)	1.418	464
Rritja e korrigjimit të vlerës së kërkesave të punës (shënimi 14)	442	464
Rritja/shlyerja e kërkesave të dyshimta dhe kontestimore	4	(77)
Efekti i diferencave të llogaritura të kursit	13	1
Gjendja më 31 dhjetor	564.844	407.814

30. Mjete të tjera

	2022	2021
Shpenzimet e llogaritura për kartëmonedhat dhe monedhat e furnizuara	172.380	75.778
Kërkesat të tjera në valutë të huaj	23.615	281
Materiale Zyre dhe të tjera	12.592	12.325
Shpenzime tjera të llogaritura	6.671	5.503
Avanset e dhëna	5.816	43.770
Mjetet në baza të tjera	129	59
Mjetet e ndërmarra në bazë të kërkesave të papaguara	55.848	55.848
Dëmtimi i të ndërmarra në bazë të kërkesave të papaguara	(55.848)	(55.848)
Gjithsej	221.203	137.716
Rrjedhëse	208.611	125.391
Jo-rrjedhëse	12.592	12.325

Shpenzimet e llogaritura për kartëmonedhat dhe monedhat e furnizuara i referohen detyrimeve kontraktuale të paguara për kartëmonedhat dhe monedhat e furnizuara. Avanset e dhëna në vitin 2021 kryesisht i referohen avanseve të paguara në pajtim me marrëveshjet që kanë të bëjnë me objektin e ri afarist. Për shkak të përfundimit të kontratës në vitin 2022, avanset e dhëna janë arkëtuar nëpërmjet aktivizimit të garancisë së avansit të lëshuar nga kontraktori.

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Raporti financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë MKD, përderisa nuk është përcaktuar ndryshe)***31. Monedha në qarkullim**

Monedha në qarkullim arrinë në:

MKD	Vlera nominale	2022 Copë	Vlera në mijë MKD	2021 Copë	Vlera në mijë MKD
Monedha në qarkullim (mjet ligjor për pagesë)					
Kartmonedha	100	17.701.456	1.770.146	16.519.578	1.651.958
	200	941.142	188.228	1.333.335	266.667
	500	10.572.856	5.286.428	11.282.603	5.641.301
	1000	22.696.936	22.696.936	22.596.970	22.596.970
	2000	10.892.251	21.784.502	9.606.016	19.212.032
Gjithsej kartmonedha			51.726.240		49.368.928
Kartmonedh at plastike polimerike	10	29.567.556	295.676	25.961.988	259.620
	50	6.400.562	320.028	5.850.292	292.515
Gjithsej kartmonedha plastike polimerike			615.704		552.135
Monedha	1	123.522.884	123.523	115.542.580	115.542
	2	87.785.204	175.570	83.501.859	167.004
	5	47.888.934	239.445	44.722.791	223.614
	10	39.161.315	391.613	38.060.758	380.608
	50	5.538.878	276.944	5.613.906	280.695
Gjithsej monedha			1.207.095		1.167.463
Gjithsej monedha në qarkullim (mjet ligjor për pagesë)			53.549.039		51.088.526
Monedha në qarkullim – monedha për qëllime koleksionimi					
Monedha	10	91.922	919	91.912	919
	100	101.344	10.135	101.304	10.130
	1000	557	557	557	557
	2000	45	90	45	90
Gjithsej monedha në qarkullim – monedha për qëllime koleksionimi			11.701		11.696
Monedha në qarkullim që nuk janë mjet ligjor për pagesë					
Monedha	0,5	4.345.792	2.173	4.345.792	2.173
Kartmonedha	10	16.922.578	169.226	16.928.588	169.286
Kartmonedha	50	2.253.692	112.684	2.254.635	112.732
Kartmonedha	5000	1.543	7.715	1.605	8.025
Gjithsej monedha në qarkullim që nuk janë mjet ligjor për pagesë			291.798		292.216
Gjithsej monedha në qarkullim			53.852.538		51.392.438

32. Depozita të bankave dhe kursimoreve

	2022	2021
Depozitat në dispozicion të bankave dhe kursimoreve në MKD në Bankën Popullore	48.793.233	36.067.024
Depozitat bankare dhe llogaritë tjera të institucioneve financiare në MKD në Bankën Popullore	19.037.564	30.637.968
Depozitat bankare në valutë të huaj– MIPS EUR	5.602.864	6.739.690
Depozita të bankave në valutë të huaj me afat deri në 1 muaj	738.484	616.072
Depozita të bankave në valutë të huaj me afat deri prej 1 deri në 3 muaj	123.120	-
Gjithsej	74.295.265	74.060.754
Rrjedhëse	74.295.265	74.060.754

Bankat vendase, filialet e bankave të huaja dhe kursimoret²¹ kanë të drejtë të vendosjes mjete në depozita të disponueshme në Bankën Popullore. Afatet e maturimit të depozitave janë një ditë pune (njëditore) dhe shtatë ditë, pa mundësinë e tërheqjes së parakohshme, pjesërisht ose plotësisht.

Gjatë vitit 2022, normat e interesit për depozitat njëditore të disponueshme lëviznin në intervalin prej 0,15% në 2,65% në vit (2021: 0,15% në vit), ndërsa normat e interesit për depozitat e disponueshme deri në shtatë ditë lëviznin prej 0,3% në 2,7% në vit (2021: 0,3 % në vit). Depozitat e disponueshme deri në shtatë ditë në bankat dhe shtëpitë e kursimeve e përfshijnë interesin e llogaritur në shumë prej 1.234 mijë MKD (2021: 24 mijë MKD).

Detyrimet e bazuara të depozitave në banka dhe llogaritë tjera të institucioneve financiare në MKD pasqyrojnë gjendjen e llogarive të tyre në Bankën Popullore për shlyerjen e transaksioneve të pagesave. Mjetet e këtyre llogarive përfshihen në përmbushjen e rezervës së detyrueshme në denarë.

Banka Popullore nuk paguan interes për mjetet e llogarive në denarë të bankave në Bankën Popullore përmes të cilave e përmbushin obligimin për rezervën e detyrueshme dhe mjetet e mbetura të llogarive, si dhe të llogarive të institucioneve financiare²².

Për qëllime të shlyerjes së bankave vendase, Banka Popullore ka hapur llogari në euro në MIPS, për lidhje me eurosistemin e pagesave TARGET 2.

²¹ Në pajtim me Vendimit e Depozitave në Dispozicion, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 263/22.

²² Llogaritë e Bankës për Zhvillim të Republikës së Maqedonisë së Veriut për projekte të ndryshme.

32. Depozita të bankave dhe kursimoreve (vazhdon)

Normat e interesit për depozitat e vendosjes në valutë të huaj me afat deri në 1 muaj, gjatë vitit 2022, lëviznin prej -0,40% në 1,2% në vit (2021: -0,40% në vit). Depozitat bankare në valutë të huaj me afat deri në 1 muaj përfshijnë detyrimet në bazë të interesit të llogaritur në vlerë prej 566 mijë MKD (2021: kërkesa në bazë të interesit të llogaritur në vlerë prej 198 mijë MKD).

Normat e interesit për depozitat e vendosura në valutë me afat prej 1 deri në 3 muaj, gjatë vitit 2022, lëviznin prej -0,37% deri në 1,7% me bazë vjetore. Depozitat e bankave në valutë me afat prej 1 deri në 3 muaj përfshijnë detyrimet në bazë të interesit të llogaritur në vlerë prej 134 mijë MKD (2021: bankat vendase nuk kanë pasur vendosje në depozita në valutë me afat prej 1 deri në 3 muaj).

33. Rezerva e detyruar e bankave në valutë dhe rezerva e detyruar e kursimoreve në denarë

	2022	2021
Rezerva e detyruar e bankave në valutë	27.125.601	19.935.455
Rezerva e detyruar e kursimoreve në MKD	23.366	25.207
Gjithsej	27.148.967	19.960.662
Rrjedhëse	27.148.967	19.960.662

Në pajtim me rregulloren, bankat kanë obligim për të përmbushur rezervën e detyruar në denarë dhe në valutë, ndërsa kursimoret kanë obligim të mbajnë rezervë të detyrueshme në denarë. Detyrimi i rezervës së detyrueshme të shtëpive të kursimit përmbushet në nivel fiks.

Gjatë vitit 2021 dhe në periudhën nga janari deri në gusht 2022, Banka Popullore përcaktoi tarifën për shumën e rezervës së detyrueshme të ndarë në euro, në normë të barabartë me normën e interesit të depozitës së disponueshme njëditore të Bankës Qendrore Evropiane që ishte e vlefshme në ditën e fundit të periudhës së përmbushjes, si dhe tarifën e fondeve të tepërta mbi shumën e rezervës së detyrueshme të ndarë me të njëjtin normë të reduktuar për 0,15 pikë përqindje. Duke filluar nga gushti 2022, Banka Popullore përcakton tarifën për shumën e rezervës së detyrueshme të ndarë në euro, në një normë të barabartë me normën më të ulët prej 0% dhe normën e interesit të depozitës së disponueshme njëditore të Bankës Qendrore Evropiane që ishte e vlefshme në ditën e fundit të periudhës së përmbushjes, si dhe tarifën për fondet e tepërta mbi shumën e rezervës së detyrueshme të ndarë, në të njëjtën normë, të reduktuar për 0,15 pikë përqindje²³.

²³ Në pajtim me Vendimin e Rezervës së Detyruar, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 177/21, 83/22, 153/22, 201/22 dhe 251/22.

33. Rezerva e detyruar e bankave në valutë dhe rezerva e detyruar e kursimoreve në denarë (vazhdon)

Në vitin 2022, norma e interesit me të cilën Banka Popullore ka llogaritur tarifën për shumën e rezervës së detyrueshme të ndarë në euro ishte -0,50% në vit (në vitin 2021: -0,50% në nivel vjetor).

Në vitin 2022, norma e interesit me të cilën Banka Popullore ka llogaritur tarifën për fondet e tepërta të ndara në llogarinë valutore në euro në MIPS, e cila është 5% më e lartë se rezerva e detyrueshme e llogaritur në euro, lëvizte prej -0,65% në -0,15% në bazë vjetore (2021: -0,65% në bazë vjetore).

Më 31 dhjetor 2022, Banka Popullore nuk ka kërkesa në bazë të interesit të llogaritur për rezervën e detyrueshme të bankave në valutë (në vitin 2021: 4.956 mijë MKD).

34. Bono të thesarit të Bankës Popullore

Në vitin 2022, të ankandëve të bonove të thesarit me aplikimin e tenderit me sasi të kufizuar dhe normë fikse të interesit. Duke filluar nga nëntori i vitit 2022, përveç bankave dhe filialeve të bankave të huaja, të drejtë për pjesëmarrje në ankandet për bono të thesarit kanë edhe kursimoret²⁴.

Norma e interesit e bonove të thesarit gjatë vitit 2022 lëvizte në intervalin prej 1,25% deri 4,75% në bazë vjetore (2021: në periudhën nga janari i dekadës së parë në mars 2021, norma e interesit e bonove të thesarit ishte 1,5%. Nga fillimi i dekadës së dytë të marsit, norma e interesit për bonot e thesarit është ulur për 0,25 pikë përqindje dhe përfundimisht më 31.12.2021 ishte 1,25%).

Më 31 dhjetor 2022, interesi i llogaritur në bonot e thesarit të Bankës Popullore ishte 21,126 mijë MKD (2021: 5.545 mijë MKD).

Rrjedha e fondeve për bono të thesarit në Bankën Popullore është si vijon:

	2022	2021
Gjendja më 1 janar	9.993.065	9.994.589
Bono të thesarit në Bankën Popullore, prurjet	99.140.328	119.867.110
Bono të thesarit në Bankën Popullore, daljet	(99.879.000)	(120.000.000)
Lirim, prurjet	196.186	131.366
Gjendja më 31 dhjetor	9.450.579	9.993.065

²⁴ Në pajtim me Vendimin e Bonove të Thesarit, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 263/22.

35. Detyrime në bazë të transaksioneve repo në valutë të huaj

	2022	2021
Transaksionet repo në valutë të huaj me kolateral të dhënë në letra me vlerë	22.915.335	2.127.069
Transaksionet repo në valutë të huaj me kolateral të dhënë në ari	4.440.273	6.236.602
Gjithsej	27.355.608	8.363.671
Rrjedhëse	27.355.608	8.363.671

Në vitin 2022 dhe 2021, Banka Popullore lidhi transaksione repo klasike me bankat e huaja me kolateral të dhënë në letra me vlerë të huaj dhe ari (shënimi 2Ç).

Vlera e përgjithshme e tregut të kolateralit të dhënë është 27.219.768 mijë MKD, prej të cilave vlera e tregut të kolateralit të dhënë në ari është 4.388.521 mijë MKD, ndërsa vlera e tregut të kolateralit të dhënë në letrat me vlerë të huaja është 22.831.247 mijë MKD (2021: vlera e tregut nga kolaterali i dhënë në ari ishte 6.333.785 mijë MKD, ndërsa vlera e tregut të kolateralit të dhënë në letrat me vlerë të huaja ishte 2.123.282 mijë MKD).

Detyrimet në bazë të repo-transaksioneve në valutë me kolateral të dhënë në letra me vlerë, më 31 dhjetor 2022, i përfshijnë edhe detyrimet në bazë të interesit të përlogaritur në vlerë prej 9.394 mijë MKD (2021: kërkesa në bazë të interesit të përlogaritur në vlerë prej 827 mijë denarë), ndërsa, nga ana tjetër, detyrimet e bazuara në repo transaksionet në valutë me kolateral të dhënë në ari, më 31 dhjetor 2022, përfshijnë kërkesat në bazë të interesit të llogaritur në vlerë prej 2.736 mijë MKD (2021: kërkesat në bazë të interesit të llogaritur në shumën prej 1.949 mijë MKD).

36. Depozitat në denarë të shtetit

Banka Popullore kryen punë depozitimi për shtetin dhe për organet e administratës shtetërore, në pajtim me Ligjin e Bankës Popullore.

	2022	2021
Llogari e vetme e thesarit	23.113.816	23.988.875
Depozita të tjera në denarë	869.764	930.731
Gjithsej	23.983.580	24.919.606
Rrjedhëse	23.983.580	24.919.606

36. Depozitat në denarë të shtetit (vazhdon)

Banka Popullore paguan interes për depozitat shtetërore në denarë në pajtim me Vendimin për llogaritjen dhe pagesën e interesit të depozitave të organeve të administratës shtetërore në Bankën Popullore²⁵.

Norma e interesit për depozitat në denarë shtetërore në periudhën janar-gusht 2022 është përcaktuar në nivel të normës së interesit për depozitat në dispozicion me afat njëditorë të Bankës Popullore dhe ka lëvizur nga 0,15% deri në 0,40% në bazë vjetore. Sipas ndryshimit të Vendimit për llogaritjen dhe pagesën e interesit, duke filluar nga shtatori i vitit 2022, norma e interesit për depozitat në denarë shtetërore caktohet në lartësinë e normës mujore të ponderuar të interesit të bankave për depozitat njëditorë në denarë për institucionet jofinanciare pa klauzola valutore dhe në periudhën shtator-dhjetor 2022 lëvizte nga 0,04% në 0,10% në bazë vjetore (2021: 0,15% në bazë vjetore).

Depozitat shtetërore përfshijnë interesin e përlogaritur në vlerë prej 413 mijë MKD (2021: 775 mijë MKD).

37. Depozitat në valutë të huaj të shtetit

Në pajtim me Ligjin e Bankës Popullore dhe Ligjin e Veprimtarisë me Valutë të Huaj, Banka Popullore është agjente e shtetit për kryerjen e qarkullimit të pagesave me shtetet e huaja. Organet e qeverisjes qendrore të shtetit dhe një pjesë e fondeve publike depozitojnë prurjet e tyre valutore në llogaritë në valutë në Bankën Popullore, me kusht që Ministria e Financave t'i miratojë të hapin një llogari të tillë. Më 31 dhjetor 2022, këto depozita arrijnë në 16.360.703 mijë MKD (2021: 22.067.344 mijë MKD).

Banka Popullore paguan interes për depozitat e shtetit në valutë në pajtim me dispozitat e Vendimit për llogaritjen dhe pagesën e interesit për depozitat e organeve të administratës shtetërore në Bankën Popullore²⁶.

37. Depozitat në valutë të huaj të shtetit (vazhdon)

Norma e interesit të depozitave në valutë të huaj të shtetit në periudhën janar-gusht 2022 është përcaktuar në nivelin e normës së interesit të depozitave njëditorë të disponueshme të Bankës Qendrore Europiane, dhe nëse norma e interesit është negative (-0,50% në

²⁵ Në pajtim me Vendimin për llogaritjen dhe pagesën e interesit të depozitave të organeve të administratës shtetërore në Bankën Popullore, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 218/16, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.183/22, interesi paguhet në depozitat pa afat të organeve të administratës shtetërore më së shumti në lartësi të para përcaktuar e cila për depozitat në denarë është 6.000.000 mijë MKD.

²⁶ Në pajtim me Vendimin për llogaritjen dhe pagesën e interesit të depozitave të organeve të administratës shtetërore në Bankën Popullore, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 218/16, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.183/22, interesi paguhet në depozitat pa afat të organeve të administratës shtetërore më së shumti në lartësi të para përcaktuar e cila për depozitat në denarë është 100.000 EURO.

periudhën nga janari deri në korrik 2022 dhe 0% deri në fund të gushtit 2022) atëherë nuk llogaritet interesi, gjegjësisht është zero denarë.

Sipas ndryshimit të Vendimit për llogaritjen dhe pagesën e interesit, duke filluar nga shtatori 2022, norma e interesit për depozitat në valutë përcaktohet në lartësinë e normës mujore të ponderuar të interesit të bankave për depozitat njëditore në valutë të institucioneve jofinanciare në euro dhe në periudhën nga shtatori deri në dhjetor 2022 ishte 0,01% në bazë vjetore (2021: norma e interesit për depozitat e disponueshme njëditore me afat të Bankës Qendrore Europiane ishte negative dhe arriti në -0,50%, kështu që sipas Vendimit nuk është llogaritur interes për këto depozitat.

38. Depozita të kufizuara

Depozitat e kufizuara përfshijnë kryesisht mjetet valutore të deponentëve (shtetit) të cilët presin ekzekutim të remitencave jashtë vendit dhe mjetet e deponentëve (shteti) që përfaqësojnë 100% mbulim për akreditiv të hapur për llogarinë e tyre nga Banka Popullore. Banka Popullore nuk paguan interes për këto depozita. Gjendja e këtyre mjeteve më 31 dhjetor 2022 është 142.111 mijë MKD (2021: 137.929 mijë MKD).

39. Detyrimet ndaj FMN-së

Detyrimet ndaj FMN-së përbëhen nga detyrimet e bazuara në alokimin kumulativ neto, detyrimet e bazuara në përdorimin e kredive të FMN-së në emër dhe për llogari të shtetit, dhe detyrimet e bazuara në anëtarësimin dhe depozitat në FMN.

a) Detyrimet në bazë të alokimit të DTS-së - në emër dhe në llogari të shtetit

Me vendimin e Bordit Ekzekutiv të FMN-së të 14 dhjetorit 1992, në pajtim me Ligjin për trashëgiminë juridike të Republikës së Maqedonisë për anëtarësim në FMN, shteti trashëgoi 5,4% të detyrimit në bazë të alokimit neto të DTS-së nga ish-Jugosllavia, në vlerë prej 642.356 mijë MKD (8.379 mijë DTS).

Me Vendimin e Bordit Ekzekutiv të FMN-së të 7 gushtit 2009, shteti ka marrë alokim të përgjithshëm neto kumulativ të DTS-së në vlerë prej 3.915.786 mijë MKD (51.076 mijë DTS). Me hyrjen në fuqi të amendamentit të katërt të Statutit të FMN-së më 10 gusht 2009 dhe në bazë të Vendimit të Bordit Ekzekutiv të FMN-së nga viti 1997, shteti mori një alokim special neto kumulativ të DTS-së në shumën prej 472.408 mijë MKD (6.162 mijë DTS).

39. Detyrimet ndaj FMN-së (vazhdon)

a) Detyrimet në bazë të alokimit të DTS-së - në emër dhe në llogari të shtetit (vazhdon)

Me Vendimin e Bordit Ekzekutiv të FMN-së nga 2 gushti i vitit 2021, shteti ka marrë alokim të përgjithshëm neto kumulativ të DTS-së në vlerë prej 10.309.305 mijë MKD (134.471 mijë DTS). Miratimi i alokimit të fondeve është për vendet anëtare të FMN-së pjesëmarrëse në Njësinë e DTS-së në raport me kuotat e tyre ekzistuese në FMN-në dhe synon të sigurojë likuiditet më të madh në sistemin ekonomik global duke mbështetur rezervat valutore të vendeve anëtare të FMN-së.

Raporti financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë MKD, përderisa nuk është përcaktuar ndryshe)*

Detyrimi i përgjithshëm i Republikës së Maqedonisë së Veriut për alokimin e DTS-së në fund të vitit 2022 është 15.339.855 mijë MKD, ose 200,088 mijë DTS (2021: 15.24.012 mijë MKD, ose 200.088 mijë DTS).

Sipas Statutit të FMN-së, detyrimi për alokimin e DTS-së është i detyrueshëm për arkëtim vetëm në rastin dhe në shumën e alokimit të anuluar të DTS-së, e cila kërkon vendim nga Bordi i Guvernatorëve të FMN-së, me shumicë të votave prej 85%, ose në rast shfuqizimi të pjesëmarrjes në Njësine e DTS-së në kuadër të FMN-së.

Banka Popullore paguan interes për shumën e përgjithshme të detyrimit në bazë të alokimit të DTS-së (200.088.116 DTS), e llogaritur me normën bazë të interesit të FMN-së. Banka Popullore rimbursin interesin e paguar për obligimin në bazë të alokimit të DTS-së nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

b) Detyrimet në bazë të kredive të përdorura nga FMN, në emër dhe në llogari të shtetit

	2022	2021
Detyrimet në bazë të kredive të përdorura nga FMN në emër dhe në llogari të shtetit (RFI Linjës së kredisë)	10.823.523	10.706.402
Detyrimet në bazë të kredive të përdorura nga FMN në emër dhe në llogari të shtetit (PLL Linjës së kredisë)	6.480.058	-
Gjithsej (shënimi 22)	17.303.581	10.706.402
Rrjedhëse	2.782.752	18.839
Jo rrjedhëse	14.520.829	10.687.563

39. Detyrimet ndaj FMN-së (vazhdon)

b) Detyrimet në bazë të kredive të përdorura nga FMN, në emër dhe në llogari të shtetit (vazhdon)

Në prill të vitit 2020, shteti ka marrë hua nga FMN-ja me Instrumentin e Shpejtë të Financimit (RFI) në vlerë prej 140.300 mijë DTS (100% e kuotës), dedikuar për mbështetjen e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë gjendjes së

jashtëzakonshme²⁷. Afati për shlyerjen e shumës së tërhequr nga instrumenti është nga tre vjet e tre muaj deri në pesë vjet nga tërheqja. Shlyerja e shumës së tërhequr nga instrumenti do të bëhet në tetë këste të barabarta tremujore. Shlyerja e kështit të parë do të fillojë në korrik të vitit 2023.

Në nëntor të vitit 2022, shtetit iu miratuan mjete nga linja kreditore e maturisë dhe likuiditet (PLL) nga FMN, në vlerë prej 406.870 mijë DTS (290% e kuotës), me qëllim mbështetjen e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut²⁸, nga e cila shteti tërhoqi shumën prej 84.180 mijë DTS (60% e kuotës). Afati për shlyerjen e shumës së tërhequr nga linja e kredisë është nga tre vjet e tre muaj deri në pesë vjet nga tërheqja. Shlyerja e shumës së tërhequr nga instrumenti do të bëhet në tetë këste të barabarta tremujore. Shlyerja e kështit të parë do të fillojë në shkurt të vitit 2026.

Detyrimi i përgjithshëm i Republikës së Maqedonisë së Veriut në bazë të kredive të shfrytëzuara nga FMN-ja në fund të vitit 2022 është 17.303.581 mijë MKD, ose 224.480 mijë DTS (2021: 10.706.402 mijë MKD, ose 140.300 mijë DTS).

Për shumat e tërhequra nga instrumentet zbatohet normë interesi e përcaktuar sipas rregullave të FMN-së, në pajtim me kushtet e financimit që vlejnë për linjat e kreditit.

Detyrimet e bazuara në kreditë e shfrytëzuara nga FMN-ja, në emër dhe në llogari të shtetit, më 31 dhjetor 2022, përfshijnë interesin e llogaritur në vlerë prej 93.710 mijë MKD (2021: 18.839 mijë MKD).

39. Detyrimet ndaj FMN-së (vazhdon)

в) Detyrimet në bazë të anëtarësimit dhe depozita

	2022	2021
Detyrimet në bazë të kambialeve të lëshuara për anëtarësim në FMN	11.043.104	10.208.567
Detyrimet në bazë të llogarisë 1	27.677	25.586
Detyrimet në bazë të llogarisë 2	160	148
Gjithsej	11.070.941	10.234.301
Rjedhëse	11.070.941	10.234.301

Në shkurt 2016, hyri në fuqi Rezoluta Nr. 66-2 mbi Rishikimin e Katërmbëdhjetë të Përgjithshëm të Kuotave dhe Reformës së Bordit Ekzekutiv, miratuar më 15 dhjetor 2010 nga Bordi i Guvernatorëve të FMN-së, i cili propozoi rritje të kuotave të secilit prej vendeve

²⁷ Në bazë të Dekretit me fuqi juridike për borxhin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ndaj FMN-së për mbështetje financiare nga instrumenti për financim të shpejtë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 100/20.

²⁸ Në bazë të Dekretit me fuqi ligjore për huamarrje të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga FMN-ja për linjë kreditore për kujdesshmëri dhe likuiditet, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 246/22.

anëtare në FMN. Sipas Rezolutës, kuota e vendit për anëtarësim në FMN në vitin 2016 u rrit nga 68.900 mijë DTS ekzistuese në 140.300 mijë DTS. Për anëtarësimin në FMN-së, Banka Popullore, si agjent fiskal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka lëshuar kambiale (shënim 23).

40. Depozita të tjera

	2022	2021
Detyrimet e bazuara në depozita në denarë ndaj subjekteve tjera vendore	2.751.411	2.329.388
Detyrimet në bazë të depozitave në denarë në institucionet financiare ndërkombëtare (IBRD ²⁹ , IDA ³⁰ dhe MIGA ³¹)	11.102	4.376
Gjithsej	2.762.513	2.333.764
Rrjedhëse	2.762.513	2.333.764

Detyrimet e bazuara në depozitat në denarë ndaj subjekteve të tjera vendore përbëhen nga: llogaria e Fondit Garantues rezervë të KIBS-it, llogaritë e klientëve të shoqërive brokeruese dhe llogaritë e Depozituesit Qendror të letrave me vlerë. Llogaritë e klientëve të shoqërive të brokerimit dhe llogaritë e Depozituesit Qendror të letrave me vlerë përdoren për të shlyer transaksionet e letrave me vlerë. Banka Popullore nuk paguan interes për këto depozita.

Llogaritë në denarë të institucioneve financiare ndërkombëtare depozitohen në Bankën Popullore. Banka Popullore nuk paguan interes për këto depozita.

41. Rezerva të veçanta

	2022	2021
Rezerva të veçanta për detyrimet e mundshme në bazë të mosmarrëveshjeve-kontesteve juridike me persona fizikë dhe juridikë	344	322
Gjithsej	344	322

Rezerva të veçanta për detyrimet e mundshme në bazë të mosmarrëveshjeve-kontesteve juridike i referohet shumës së kryegjësë dhe interesit që Banka Popullore pret që ndoshta do të duhet t'u paguajë personave fizikë dhe juridikë që kanë ngritur padi kundër Bankës Popullore, pas përfundimit të procedurës ligjore.

Lëvizja e rezervës së veçantë për detyrimet e mundshme bazuar në mosmarrëveshjet-kontestet gjyqësore është paraqitur më poshtë:

²⁹ Banka Ndërkombëtare e Rindërtimit dhe Zhvillimit (International Bank for Reconstruction and Development) – IBRD.

³⁰ Agjencia e Zhvillimit Ndërkombëtar (International Development Association) – IDA.

³¹ Agjencia Shumëpalëshe e Garantimit t[Investimeve (Multilateral Investment Guarantee Agency) – MIGA.

Raporti financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë MKD, përderisa nuk është përcaktuar ndryshe)*

	2022	2021
Gjendja më 1 janar	322	247
Ndarja e rezervës së veçantë për detyrimet e mundshme të mosmarrëveshjeve gjyqësore (shënimi 14)	22	75
Gjendja më 31 dhjetor	344	322

42. Detyrime të tjera

Detyrimet janë analizuar në mënyrën si vijon:

	2022	2021
Mjetet e depozituara në bazë të tërheqjes efektive dhe (garancë e pagesës së borxhit)	280.666	285.235
Detyrimet që rrjedhin nga falimentimi i BTJ-së	144.895	144.895
Interesi i llogaritur në valutë të huaj bazuar në marrëveshjet e lidhura	70.419	1.395
Detyrimet e bazuara në përfitimet afatgjata të punonjësve	38.784	42.669
Detyrimet ndaj furnitorëve dhe detyrime të tjera	16.354	21.731
Kundërzë e monedhave të përshtatshme	5.612	5.386
Të ardhurat e shtyra	4.126	5.247
Detyrimet në bazë të taksave	2.340	6.501
Detyrimet në bazë të qirasë	803	1.764
Detyrime në bazë të fitimit të shpërndarë	-	46.108
Gjithsej	563.999	560.931

42. Detyrimet të tjera (vazhdon)

Detyrimet në bazë të mjeteve të depozituara në bazë të mjeteve efektive të konfiskuara dhe garancive të depozituara i referohen mjeteve të depozituara në valutë të cilat organet kompetente shtetërore ua sekuestruan si masë detyruese personave juridikë dhe fizikë dhe kundër të cilave kanë ngritur padi në gjykatat kompetente. Në varësi të aktvendimit të gjykatës, këto valuta i kthehen personit nga i cili janë marrë ose paguhet në kundërvlerë të denarit në buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Banka Popullore nuk paguan interes për këto mjete.

Detyrimet që rrjedhin nga falimentimi i Bankës për Tregti të Jashtme (BTJ) i referohen detyrimeve të trashëguara të Bankës Popullore në bazë të depozitave të kursimeve të qytetarëve të kapura në kohën e shpalljes së falimentimit të Bankës në vitin 1995, në shumën 292.442. mijë MKD. Për shlyerjen e këtyre detyrimeve, nga pasuria e falimentimit të BTJ-së, nga Banka Popullore i janë siguruar pasuri të paluajtshme të cilat ajo menjëherë, pa kompensim, ia dorëzoi Qeverisë.

Interesi i llogaritur në valutë të huaj në bazë të marrëveshjeve të lidhura i referohet interesit të llogaritur në bazë të alokimit neto kumulativ (ANK) nga FMN, në emër dhe në llogari të shtetit.

Detyrimet e bazuara në përfitimet afatgjata të punonjësve, me përjashtim të kontributeve të sigurimit pensional, janë të barabarta me shumën e përfitimeve të ardhshme të realizuara nga punonjësit në bazë të punës së tyre në periudhat aktuale dhe të kaluara, të skontuara në vlerën e kontabilitetit të saj duke aplikuar normë interesi të ponderuar vjetore prej 3,9045% e obligacioneve afatgjata të lëshuara nga shteti gjatë vitit 2022 me afat maturimi më shumë se 5 vjet.

Detyrimet në bazë të fitimit të shpërndarë në vitin 2021 i referohen fitimit të shpërndarë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me dispozitat e Ligjit të Bankës Popullore. Në vitin 2022, Banka Popullore nuk do të shpërndajë fitim në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për shkak të rezultatit financiar negativ neto të llogaritur për shpërndarje (shënimi 43).

43. Kapitali dhe rezervat

Kapitali

Kapitali i Bankës Popullore është përcaktuar me Ligjin e Bankës Popullore dhe më 31 dhjetor të vitit 2022 ai është 1.289.789 mijë MKD (në vitin 2021: 1.289.789 mijë MKD).

Rezerva të përgjithshme dhe speciale

Në pajtim me dispozitat e Ligjit të Bankës Popullore, nga rezultati financiar i përcaktuar për shpërndarje, 70% shpërndahen në rezervat e përgjithshme deri në arritjen e nivelit të kapitalit bazë të Bankës Popullore. Pas arritjes së nivelit të kapitalit bazë, 15% nga pjesa tjetër e fitimit shpërndahen në rezervat e përgjithshme, ndërsa pjesa tjetër shpërndahet në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në rast të llogarisë së hapur për rezerva speciale³², rezultati financiar për shpërndarje mund të shpërndahet në atë mënyrë që maksimumi 70% të mund të transferohet në llogarinë për rezerva speciale deri në arritjen e shumës së përcaktuar nga Këshilli i Bankës Popullore për mbulimin e shpenzimeve për qëllimet e parashikuara, dhe nga pjesa tjetër, 70% shpërndahet në rezervën e përgjithshme deri në arritjen e nivelit të kapitalit bazë, gjegjësisht 15% pas arritjes së nivelit të kapitalit bazë. Rezervat e përgjithshme përdoren vetëm për mbulimin e humbjeve të Bankës Popullore. Më 31 dhjetor 2022, pjesë e rezervës së përgjithshme janë përdor për mbulimin e rezultatit financiar negativ neto të llogaritur për shpërndarje për vitin 2022 në vlerë prej 902,067 mijë MKD.

	2022	2021
Rezerva të përgjithshme	432.826	1.334.893
Rezerva speciale	843.987	843.987

³² Përcaktuar si llogari rezervë speciale në Ligjin për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në vitin 2015, Banka Popullore hapi llogari për rezerva speciale për mbulimin e shpenzimeve për qëllime të paraplanifikuara, me qëllim special që lidhet me ndërtimin e objektit të ri afarist.

43. Kapitali dhe rezervat (vazhdon)*Rezervat e rivlerësimit*

	2022	2021
Rezervat e rivlerësimit nga ndryshimet e përealizuara të kursit të këmbimit dhe çmimeve		
Rezervat e rivlerësimit nga diferencat e kursit të këmbimit	79.669	129.782
Rezervat e rivlerësimit nga ndryshimet e çmimit dhe të kursit të këmbimit të arit	9.817.262	10.947.211
Rezervat e rivlerësimit nga ndryshimet e çmimeve të letrave me vlerë të matura me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave	32.296	17.041
Rezervat e rivlerësimit nga ndryshimet e çmimeve të letrave me vlerë të matura me vlerën e drejtë përmes fitimeve të tjera gjithpërfshirëse	502	-
Gjithsej	9.929.729	11.094.034

Rezervat e rivlerësimit përfaqësojnë ndryshimet e akumuluar të kursit pozitiv neto të përealizuar dhe të çmimeve nga rivlerësimet periodike të kursit të këmbimit dhe çmimit të mjeteve dhe detyrimeve në valutë, të cilat përdoren si rezervë kundrejt tendencave të mundshme negative të ardhshme në lëvizjen e kursit të këmbimit dhe ndryshimeve të çmimeve, përkatësisht.

Në vitin 2022, rezerva e rivlerësimit nga diferencat e këmbimit nga mjetet dhe detyrimet në valutë u zvogëluar për shkak të mbulimit të diferencave neto negative të përealizuara në këmbim në vlerë prej 50.113 mijë MKD (2021: rritje për shkak të ndarjes së diferencave neto pozitive të përealizuara të kursit në shumë prej 129.782 mijë MKD) .

Rezerva e rivlerësimit nga ndryshimet e çmimeve dhe kursit të këmbimit të arit në vitin 2022 është zvogëluar në bazë neto në vlerë prej 1.129.949 mijë MKD nga të cilat:

- Rritje prej 1.061.491 mijë MKD, si rezultat i shpërndarjes së çmimit pozitiv të përealizuar neto dhe diferencave të kursit të këmbimit të arit (2021: çmimi pozitiv neto i përealizuar dhe diferencat e kursit të këmbimit të arit në vlerë prej 850.039 mijë MKD) dhe
- Rënie prej 2.191.440 mijë MKD, si rezultat i ndryshimeve të realizuara të kursit dhe çmimit nga transaksionet me arin në vitin 2022, të cilat i janë shtuar rezultatit financiar për shpërndarje për vitin aktual 2022 (2021: kursi i realizuar dhe ndryshimet e çmimeve nga transaksionet me arin në vlerë të përgjithshme prej 1.070.362 mijë MKD).

Rezerva e rivlerësimit nga ndryshimet e çmimeve të letrave me vlerë të matura me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave në vitin 2022 është rritur në bazë neto në shumën prej 15.255 mijë MKD, nga të cilat:

43. Kapitali dhe rezervat (vazhdon)

Rezervat e rivlerësimit (vazhdon)

- Rritje prej 32.296 mijë denarë, si rezultat i shpërndarjes së ndryshimeve pozitive neto të përealizuara të çmimeve të letrave me vlerë të matura me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave sipas parimit "letër për letër" (2021: ndryshimet neto pozitive të përealizuara të çmimeve të letrat me vlerë të matura me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave në vlerë të përgjithshme prej 7 mijë MKD);

- Rënie prej 5.599 mijë denarë, si rezultat i ndryshimeve të realizuara të çmimeve nga letrat me vlerë, të cilat i janë shtuar rezultatit të llogaritur të shpërndarjes për vitin 2022 (2021: ndryshimet e realizuara të çmimeve nga letrat me vlerë në vlerë të përgjithshme prej 47,848 mijë MKD) dhe

-Zvogëlim prej 11.442 mijë MKD, si rezultat i mbulimit të ndryshimeve neto negative të përealizuara të çmimeve të letrave me vlerë të matura me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave nga viti 2022 (2021: ndryshimet neto negative të përealizuara të çmimeve të letrave me vlerë të matura me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave në shuma e përgjithshme prej 74.897 mijë MKD).

Rezerva e rivlerësimit nga ndryshimet e çmimeve të letrave me vlerë të matura me vlerën e drejtë përmes fitimit tjetër gjithëpërfshirës, në vitin 2022, është rritur në vlerë prej 502 mijë MKD si rezultat i ndryshimeve neto pozitive të përealizuara të çmimeve në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të matura përmes fitimit tjetër gjithëpërfshirës (2021: zero MKD).

Më 31 dhjetor 2022, rezerva e rivlerësimit të veprave artistike dhe fondit të bibliotekës arrin në 4.085 mijë MKD (2021: 4.074 mijë MKD). Rritja e rezervës së rivlerësimit në vlerë prej 11 mijë MKD është bazuar në dhurimin e librave në fondin e bibliotekës së Bankës Popullore.

44. Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e saj

	2022	2021
Paratë e huaja efektive (shënimi 15)	2.964.247	3.372.659
Depozita në valutë të huaj (shënimi 16)	53.654.174	41.819.630
Të drejtat speciale të tërheqjes (shënimi 20)	24.679	80.443
Gjithsej	56.643.100	45.272.732

45. Detyrimet e mundshme dhe të ndërmarra

a) Paditë

Aktualisht udhëhiqen disa procedura gjyqësore kundër Bankës Popullore që dalin nga puna rrjedhëse. Më 31 dhjetor 2022, paditë vlerësohen në shumë prej 447.070 mijë MKD (2021: 123.666 mijë MKD). Banka Popullore i kundërshton këto padi dhe në bazë të këshillave juridike konsideron se nuk do të ketë humbje të konsiderueshme materiale.

Në vitin 2022, Banka Popullore ndau rezervë speciale në vlerë prej 22 mijë MKD për detyrimet e mundshme në bazë të kontesteve gjyqësore për të cilat pret që ndoshta do të duhet të paguajë detyrimet (2021: ndarja e rezervës speciale në vlerë prej 75 mijë MKD për kontestet gjyqësore) (shënimet 14 dhe 41).

Për pjesën tjetër të procedurave gjyqësore, Banka Popullore nuk ka ndarë asnjë rezervë, sepse në bazë të mendimit dhe këshillave juridike, udhëheqësia beson se rezultati përfundimtar do të jetë në favor të Bankës Popullore dhe se nuk do të ketë humbje materiale në raport. në procedurat gjyqësore.

b) Detyrimet e ndërmarra

Gjendja e obligimeve të ndërmarra, më 31 dhjetor 2021, në bazë të ndërtimit të objektit të ri³³, ishte 608.786 mijë MKD, prej të cilave 80.314 mijë MKD janë paguar gjatë vitit 2022. Në korrik të vitit 2022, Banka Popullore e ndërpreu kontratën për ndërtimin e objektit të ri për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit dhe në fund të vitit 2022 nuk është ndërmarrë asnjë detyrim mbi këtë bazë.

Më 31 dhjetor 2022, Banka Popullore ka ndërmarrë detyrime në bazë të kontratave të lidhura në vlerë prej 59,322 mijë MKD për investime në pajisje.

46. Transaksionet me subjektet e lidhura

Banka Popullore ka transaksione me subjektet e lidhura, me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me të gjithë anëtarët e Këshillit. Transaksionet dhe gjendjet me subjektet e lidhura tregohen në shënimet 5, 6, 12, 22, 23, 36, 37, 38 dhe 42.

47. Ngjarjet pas datës së Raportit të gjendjes financiare

³³ Kontrata për kryerjen e punimeve të ndërtimit për ndërtimin e ndërtesës së re administrative është lidhur në tetor të vitit 2016.

Raporti financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë MKD, përderisa nuk është përcaktuar ndryshe)

Pas datës së përgatitjes së Raportit mbi gjendjen financiare, nuk ka ndodhur asnjë ngjarje me rëndësi materiale që do të shkaktonte korrigjimin e raporteve financiare dhe as ngjarje që duhet të publikohen në raportet financiare.